EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8430
E enjte, 12 nëntor 2026
Çmimi 0. 50 €

Kush është Mikhail Bogachek, i nominuari i Trumpit për ambasador të ShBA-së në Kosovë? FAQE 6



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR TË MËRKURËN SEANCË TË JASHTËZAKONSHME PËR RAPORTIN E PROGRESIT TË KOMISIONIT EVROPIAN PËR KOSOVËN

OPOZITA KRITIKON QEVERINË PËR NGECJEN NË INTEGRIMIN EVROPIAN



Partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca, kanë kritikuar Qeverinë e Kosovës për mungesën e reformave dhe ngecjen në procesin e integrimit evropian, gjatë seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit, ku u diskutua për Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2026. Ndërkaq, partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, ka vlerësuar se Kosova ka shënuar përparim në rrugën drejt integrimit evropian pavarësisht prej kritikave dhe vlerësimeve të përfshira në këtë raport

SORENSENI TAKOHET ME KURTIN NË PARIS: DISKUTUAM PËR RRUGËN PËRPARA TË DIALOGUT F. 3



A MUND TA ZHBLLOKOJË DEBATI PËR SPECIALEN RRUGËN E KOSOVËS DREJT KËSHILLIT TË EVROPËS? F. 4



AKTUALE



IRANI NUK LËSHON PE PËR URANIUMIN E PASURUAR AS PËR NJË MARRËVESHJE ME SHBA-në F. 2

IKD-ja KËRKON NGA MINISTRIA E DREJTËSISË TA ZGJATË AFATIN E KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTKODIN CIVIL F. 6

DISKUTOHEN MUNDËSITË E ZGJERIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET KOSOVËS DHE IRI-t F. 7

EKONOMI



ASK: NË KOSOVË KISHTE 48 506 NDËRMARRJE AKTIVE GJATË VITIT 2025, SHËNOHET RËNIE PREJ 4-PËRQINDËSH F. 8

TAKOHEN DREJTUESIT E BQK-SË DHE BERZH-IT, NË FOKUS REFORMAT NË SEKTORIN FINANCIAR F. 8

SPORT



PËRFUNDON LIGA E SHKOLLAVE F. 11

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

IRANI NUK LËSHON PE PËR URANIUMIN E PASURUAR AS PËR NJË MARRËVESHJE ME SHBA-në

Tehran, 11 nëntor - Sekretari i Këshillit Suprem i Sigurisë Kombëtare të Iranit (SNSC) përsëriti qëndrimin e Teheranit se nuk do ta transferojë uraniumin e pasuruar në ndonjë vend tjetër edhe nëse arrin marrëveshje të paqes me Shtetet e Bashkuara.

Në një intervistë për televizionin libanez "Al Mayadeen", Mohsen Rezaei tha se Irani "nuk do të nxjerrë jashtë vendit as edhe një atom të materialit të pasuruar bërthamor ". Ai theksoi se Teherani e ka njoftuar edhe Moskën për këtë vendim.

Rusia është përmendur shpesh si një destinacion i mundshëm për rezervat iraniane të uraniumit të pasuruar.

Pjesë nga intervista e Rezaeit u publikuan më 11 nëntor, përpara transmetimit të bisedës së plotë gjatë ditës.

Përpara sulmeve të ShBA-së dhe Izraelit në qershor të vitit 2025, të cilat kishin në shënjestër tri objekte kryesore bërthamore, Agjencia Ndërkombëtare për Energjinë Atomike (IAEA) vlerësonte se Irani zotëronte 440.9 kilogramë uranium të pasuruar në nivelin 60 për qind.

Inspektorët nuk kanë arritur të verifikojnë se sa nga ky uranium u ka mbijetuar sulmeve dhe ku ruhet aktualisht.

Uraniumi i pasuruar mund të përdoret për prodhimin e energjisë bërthamore, por në nivele shumë të larta pasurimi mund të shërbejë edhe për prodhimin e armëve bërthamore.

Pasurimi në nivelin 60 për qind është shumë mbi nivelin që nevojitet për centralet bërthamore dhe jo larg nivelit prej rreth 90 për qind që përdoret për armë bërthamore.

Objektet bërthamore në Iran u goditën nga sulmet ajrore edhe pas shpërthimit të konfliktit të ri më 28 shkurt, i cili ende nuk ka marrë fund.

Rezaei, i cili u emërua sekretar i Këshillit Suprem të Sigurisë Kombëtare në gusht dhe është përfaqësues i udhëheqësit suprem të Iranit, Mojtaba Khamenei, në këtë këshill, u takua javën e kaluar në Kremlin me presidentin rus, Vladimir Putin.

Deklaratat e tij vijnë mes raportimeve për një takim të mundshëm me nënpresidentin amerikan JD Vance për të negociuar një marrëveshje që do t'i jepte fund luftës kundër Iranit, tashmë në muajin e nëntë, dhe



do të mundësonte rihapjen e Ngushticës së Hormuzit, një rrugë kyçe për transportin botëror të naftës.

Megjithatë, Rezaei mohoi se po zhvillohen bisedime mes Iranit dhe ShBA-së.

Në intervistën për "Al Mayadeen", ai i cilësoi si "gënjeshtra të pastra" raportimet për një takim të fundit mes palëve në Katar. Sipas tij, këto raportime synojnë t'i ulin çmimet e naftës, të cilat janë rritur në mbarë botën, për shkak të pasigurisë që lufta ka shkaktuar në Lindjen e Mesme.

Marrëdhëniet mes Iranit dhe ShBA-së mbeten të tensionuara.

Asnjëra palë nuk i është rikthyer luftës në shkallë të gjerë, por nuk ka pasur as ndonjë përparim të rëndësishëm drejt një marrëveshjeje të qëndrueshme paqeje.

Edhe pse luftimet intensive kryesisht janë ndalur, janë disa çështje që vazhdojnë ta pengojnë arritjen e një marrëveshjeje - mes tyre: programi bërthamor i Iranit, bllokada që marina amerikane u ka vendosur porteve iraniane dhe pengesat për kalimin e anijeve nëpër Ngushticën e Hormuzit.

Më 9 nëntor presidenti amerikan Donald Trump mbrojti luftën kundër Iranit, por tha se ajo "praktikisht ka përfunduar" në aspektin ushtarak.

Deklarata e tij la të kuptohet se Shtëpia e Bardhë ka hequr dorë nga kërcënimet e fundit për rifillimin e sulmeve ajrore.

Megjithatë, ShBA-ja pritet ta vazhdojë presionin ekonomik dhe ushtarak ndaj Iranit, sipas sekretarit amerikan të Shtetit, Marco Rubio. "Presioni ekonomik ndaj Iranit është aq shkatërrues saqë, për momentin, nuk ka nevojë për operacione të mëdha ushtarake", tha Rubio më 10 nëntor, pas takimit të ministrave të Jashtëm të grupit të vendeve më të industrializuara, G7, në Paris.

Irani nuk pranon ta rihapë Ngushticën e Hormuzit pa marrë lëshime të mëdha në këmbim. Ai kërkon lehtësimin e sanksioneve, qasje në fondet e tij të ngrira jashtë vendit, heqjen e bllokadës amerikane ndaj porteve iraniane dhe ndalimin e luftimeve në rajon, veçanërisht në Liban.

BISEDIMET UKRAINË - RUSI PËRFUNDOJNË, SULMET NUK NDALEN

Kiev, 11 nëntor - Bisedimet dyditore mes Ukrainës dhe Rusisë në Abu Dabi, të ndërmjetësuara nga Shtetet e Bashkuara, përfunduan më 11 nëntor, pas një takimi që zgjati më pak se dy orë, raportuan disa medie.

Ende nuk ka informacione nëse është arritur ndonjë përparim në negociata.

Këto ishin bisedimet e para të drejtpërdrejta mes zyrtarëve rusë dhe ukrainas që nga shkurti. Ato u mbajtën në kuadër të përpjekjeve të reja të Shtëpisë së Bardhë për të gjetur një zgjidhje që do t'i jepte fund luftës në Ukrainë - konfliktit më të madh dhe më të përgjakshëm tokësor në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore.

Në Abu Dabi u zhvilluan edhe konsultime me përfaqësues të Gjermanisë, Francës, Britanisë së Madhe, Italisë, NATO-s, Bashkimit Evropian dhe Ukrainës.

Megjithatë, këto takime me përfaqësuesit amerikanë ishin të ndara nga bisedimet trepalëshe mes ShBA-së, Ukrainës dhe Rusisë.

Ukraina njoftoi më herët se delegacioni i saj do të takohej me përfaqësuesit amerikanë dhe evropianë pas përfundimit të negociatave me Rusinë.



Pavarësisht prej bisedimeve, Rusia vazhdoi sulmet ndaj Ukrainës.

Një sulm me dronë la pjesërisht pa energji elektrike dhe ngrohje qytetin Krivij Rih, në pjesën jugqendrore të Ukrainës, njoftuan autoritetet lokale.

Nga sulmi u dëmtuan ndërtesa banimi, shkolla dhe kopshte fëmijësh, tha Oleksandr Vilkul, kreu i Këshillit të Mbrojtjes së Krivij Rihut.

Kryeministri ukrainas, Serhiy Koretskiy, njoftoi më 11 nëntor se Rusia kishte sulmuar gjatë natës gjashtë objekte të rëndësishme të furnizimit me energji elektrike në katër rajone të Ukrainës. Sipas tij, në shënjestër të sulmeve ishte edhe infrastruktura hekurudhore në rajonet e Dnipropetrovskut dhe Zhitomirit.

Ndërkohë, guvernatori i rajonit rus të Leningradit, Aleksandr Drozdenko, njoftoi në "Telegram" se mbrojtja ajrore ruse kishte rrëzuar 150 dronë ukrainas mbi këtë rajon, gjatë natës. Sipas Drozdenkos, disa dronë goditën zonën e portit Ust-Luga, ku ndodhet qendra më e madhe ruse për eksportin e energjisë dhe naftës në Detin Baltik.

Sulmi shkaktoi zjarr dhe la të plagosur tre punëtorë.

Në një sulm tjetër dy persona humbën jetën pasi mbetjet e një droni goditën një ndërtesë banimi në rajonin rus të Smolenskut, që kufizohet me Bjellorusinë, njoftuan autoritetet rajonale.

Ministria ruse e Mbrojtjes njoftoi më 11 nëntor se forcat e saj të mbrojtjes ajrore kishin kapur dhe shkatërruar 627 dronë ukrainas gjatë natës.

Ushtria ukrainase nuk i konfirmoi sulmet në territorin rus.

Bullgaria në zi kombëtare, mjegulla dyshohet se shkaktoi tragjedinë me 86 automjete

Sofje, 11 nëntor - Bullgaria është në zi kombëtare pas aksidentit tragjik që përfshiu 86 automjete në autostradën Trakia.

Në këtë aksident humbën jetën 11 persona dhe dhjetëra të tjerë mbetën të lënduar. Aksidenti masiv ndodhi dje pranë qytetit të Jambolit, ku një seri përplasjesh zinxhirore përfshiu automjete në të dyja drejtimet e autostradës që lidh Sofjen me Burgasin.

Sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë, 51 persona u transportuan dhe u shtruan në spitale për të marrë ndihmën mjekësore, ndërsa 13 prej tyre po trajtohen në gjendje të rëndë.

Dyshimet paraprake të autoriteteve janë përqendruar te mjegulla e dendur dhe



dukshmëria e kufizuar, të cilat mund të kenë ndikuar në përmasat e aksidentit.

Megjithatë, hetuesit po shqyrtojnë edhe faktorë të tjerë, përfshirë gjendjen e asfaltit, sinjalistikën rrugore dhe shpejtësinë me të cilën lëviznin automjetet në momentin e përplasjeve.

Kryeministri Rumen Radev ka kërkuar një hetim të plotë për t'i zbardhur shkaqet dhe rrethanat e kësaj tragjedie. Ndërkohë, qeveria ka vënë në dispozicion edhe avionë ushtarakë për transportimin e të plagosurve dhe lehtësimin e operacionit të emergjencës.

Ndërkohë, Bullgaria ka shpallur ditë zie kombëtare, ndërsa hetimet për aksidentin që shkaktoi kaq shumë viktima dhe dëme materiale në një nga arteriet kryesore rrugore të vendit vijojnë.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR TË MËRKURËN SEANCË TË JASHTËZAKONSHME PËR RAPORTIN E PROGRESIT TË KOMISIONIT EVROPIAN PËR KOSOVËN

OPOZITA KRITIKON QEVERINË PËR NGECJEN NË INTEGRIMIN EVROPIAN

Partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca, kanë kritikuar Qeverinë e Kosovës për mungesën e reformave dhe ngecjen në procesin e integrimit evropian, gjatë seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit, ku u diskutua për Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2026. Ndërkaq, partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, ka vlerësuar se Kosova ka shënuar përparim në rrugën drejt integrimit evropian pavarësisht prej kritikave dhe vlerësimeve të përfshira në këtë raport



EPOKA E RE **Mal QORRAJ**

Prishtinë, 11 nëntor - Kuvendi i Kosovës ka mbajtur të mërkurën një debat parlamentar për Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2026 si dhe për adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të tij. Debati u thirr nga grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca, e kanë kritikuar Qeverinë e Kosovës për mungesën e reformave dhe ngecjen në procesin e integrimit evropian.

Shefja e grupit parlamentar e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Jehona Lushaku-Sadriu, në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit, ka thënë se raporti i Bashkimit Evropian për Kosovën është "pa progres". "Integrimi evropian i vendit tonë kërkon punë të përditshme shtetërore dhe pikërisht kjo punë ka dështuar, jo vetëm ka ngecur. Prandaj, ky është thelbi i debatit të sotëm", tha ajo.

Deputetja tha se në fushën e drejtësisë vendi për herë të parë ka "zero progres". "Një qeverisje që e ka ndërtuar identitetin e vet mbi premtimet kundër korrupsionit, duhet të përgjigjet edhe për këtë hendek mes premtimeve dhe rezultateve", tha ajo, duke kritikuar, siç u shpreh, dështimin në luftimin e korrupsionit. Ajo tha se raporti evidenton edhe shumë hendeqe të tjera.

Lushaku Sadriu e vlerësoi raportin si përgjithësisht me notë jokaluese. "Në emër të grupit parlamentar të LDK-së, kërkoj që ky debat të mos përfundojë vetëm me diskutime, por të dalim me kërkesa konkrete për Qeverinë e Kosovës, e cila duhet t'i raportojë rregullisht Kuvendit të Kosovës, çdo tre muaj, për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Progresit dhe kërkesave që dalin prej tij. Gjithashtu, brenda 30 ditësh duhet të na paraqesë një plan veprimi me hapa konkretë për përmbushjen e këtyre kritereve", tha ajo.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Arian Tahiri, ka ngritur shqetësime për gjendjen e demokracisë dhe funksionimin e institucioneve në Kosovë, duke iu referuar gjetjeve të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2026.

Gjatë debatit në Kuvendin e Kosovës, Tahiri theksoi se raporti nuk është dokument i opozitës dhe as nuk u shërben interesave të ndonjë partie politike, por paraqet një vlerësim institucional për përparimin e vendit. Ai tha se vlerësimet e Komisionit Evropian për mangësitë në demokraci, drejtësi, ekonomi dhe funksionimin e institucioneve duhet të shërbejnë si bazë për reflektim dhe jo për arsyetime politike.

Tahiri përmendi paralizën e zgjatur institucionale dhe mbikëqyrjen e kufizuar të ekzekutivit, duke i cilësuar këto si shqetësime për cilësinë e demokracisë në vend. "Një qeveri mund t'i ketë votat për të marrë vendime, por kjo nuk i jep të drejtën ta trajtojë shtetin si pronë politike", deklaroi ai.

Duke folur për sistemin e drejtësisë, shefi i GP-së së PDK-së tha se raporti evidenton mungesë progresi në funksionimin e gjyqësorit dhe paralajmëron për ndikime të padrejta në pavarësinë e tij. Sipas Tahirit, qytetarët duhet të kenë besim se trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit.

Ai kritikoi qasjen ndaj zhvillimit ekonomik, duke theksuar se buxheti nuk duhet të konsiderohet sukses në vetvete, por instrument për krijimin e zhvillimit.

Në këtë drejtim, Tahiri tha se Kosovës i nevojitet transformim ekonomik dhe institucione që punojnë në shërbim të qytetarëve. "Kosova nuk ka nevojë për institucione që i shërbejnë pushtetit, por për një pushtet që u shërben institucioneve", u shpreh ai.

Mungesa e një agjende të qartë për integrimin evropian dhe keqmenaxhimi i parasë publike ishin ndër çështjet që ngriti shefi i grupit parlamentar i Aleancës, Besnik Tahiri, gjatë debatit parlamentar për Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2026.

Tahiri vlerësoi se Kosova po kalon nëpër një proces integrues pa agjendë të qartë, duke e cilësuar vendin si shtetin me progresin më të dobët në Ballkanin Perëndimor. Ai theksoi se Kosova është i vetmi vend që ka qenë nën masat e Bashkimit Evropian për më shumë se dy vjet.

Deputeti i Aleancës ngriti shqetësime edhe për menaxhimin e parasë publike, duke thënë se korrupsioni dhe keqmenaxhimi i financave paraqesin rrezik të madh.

Tahiri kërkoi nga qeveria ndërmarrjen e tri veprimeve konkrete: caktimin e një ministri ose zëvendësministri përgjegjës për agjendën e integrimit evropian, adresimin e statusit të vendit kandidat dhe shmangien e humbjes së 131 milionë eurove nga fondet evropiane. "Kjo qeveri duhet të ndërmarrë tre hapa: caktimin e një ministri ose zëvendësministri përgjegjës për agjendën e integrimit evropian, adresimin serioz të çështjes së statusit të vendit kandidat dhe të mos lejojë të humben 131 milionë euro, ashtu siç janë humbur 43.8 milionë euro", deklaroi Tahiri.

Deputetja Liza Gashi foli në emër të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje në debatin e sotëm parlamentar për raportin e sivjetmë të Bashkimit Evropian për Kosovën, ku përmendi "sukseset dhe përparimin".

Pavarësisht se raporti, në masë të madhe, konstaton se nuk është shënuar progres, Gashi tha se përparimi është "i pamohueshëm". "Për ne si grup parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, së bashku me aleatët tanë, ky debat parlamentar po ashtu është një mundësi e mirë për t'i prezantuar sukseset dhe përparimin e pamohueshëm të Republikës së Kosovës në rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian", tha ajo.

Gashi tha se "integrimi evropian mbetet orientimi strategjik", ndërsa përmendi liberalizimin e vizave në vitin 2024 si sukses të qeverisë së udhëhequr nga LV-ja. "Gjatë kësaj dekade kemi përafruar legjislacionin me standardet evropiane, kemi zgjeruar marrëdhëniet tregtare, mbi të gjitha kemi liberalizuar vizat për vendin tonë", tha ajo. "Sot çdo qytetar i Republikës së Kosovës mund të lëvizë lirshëm në çdo cep të bllokut Schengen, por edhe më gjerë", shtoi deputetja.

Gashi tha se mosshqyrtimi i aplikimit të Kosovës për anëtarësim në BE nuk është vetëm vonesë për Kosovën, por paraqet edhe sfidë për besueshmërinë e procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian.

Deputetja e LV-së përmendi gjithashtu "bllokadën institucionale" si shkak të ngecjeve.

Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Glauk Konjufca, në emër të Qeverisë së Kosovës, ka theksuar se raporti mbulon ecurinë e punës nga shtatori 2025 deri në shtator 2026 dhe, sipas tij, gjatë kësaj periudhe Kosova ka pasur tri palë zgjedhje. "Dy palë të parakohshme dhe një palë komunale. Pa president të zgjedhur deri në tetor dhe me Kuvend jofunksional për pjesën më të madhe të kohës. Raporti konstaton se përgjatë gjithë kësaj periudhe Kuvendi punoi vetëm nga mesi i shkurtit deri në fund të prillit, ndërsa qeveria ishte në detyrë në pjesën më të madhe të periudhës. Madje edhe në këtë kohë pati një ndërprerje prej tri javësh, nga 6 marsi deri te vendimi i Gjykatës Kushtetuese më 25 mars. Sipas raportit, kjo e kufizoi efektivitetin e qeverisjes dhe i vonoi reformat strukturore. Komisioni e ndërlidh drejtpërdrejt ngadalësimin me bllokadën. Progresi në reformat e Bashkimit Evropian mbetet i pabarabartë për shkak të paqëndrueshmërisë dhe bllokadës politike", tha Konjufca, duke shtuar se në disa kapituj ka vlerësim për rënie të ritmit të reformave. "Pra ritëm më të ngadalshëm, por jo rënie në nivel tjetër, konstatim që i kishim tri palë zgjedhje, Kuvend të bllokuar dhe qeveri në detyrë", tha ai.

Raporti i Progresit ka theksuar se Kosova vazhdon të ngecë në disa nga reformat kryesore që duhet ta afrojnë me Bashkimin Evropian.

Gjyqësori nuk ka shënuar asnjë përparim, lufta kundër korrupsionit ka dhënë rezultate të kufizuara, ndërsa krizat politike kanë dobësuar funksionimin e institucioneve.

Raporti paralajmëron se ndikimet politike dhe ekonomike në sistemin e drejtësisë mbeten pengesë serioze për pavarësinë e tij dhe, në disa aspekte, madje janë rritur.

Po ashtu, raporti i progresit evidenton rënie të numrit të vendimeve përfundimtare dhe dënimeve për korrupsion të nivelit të lartë, si dhe mangësi në mbikëqyrjen parlamentare të qeverisë. Sipas këtij raporti, përparim i kufizuar është shënuar edhe në lirinë e shprehjes dhe të medieve.

Sorenseni takohet me Kurtin në Paris: Diskutuam për rrugën përpara të dialogut

Prishtinë, 11 nëntor - Përfaqësuesi i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Peter Sorensen ka zhvilluar takim me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, në Paris, ku kanë diskutuar për vazhdimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Përmes një postimi në platformën "X", zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm të BE-së për dialogun bëri me dije se në takim është diskutuar për hapat e ardhshëm në procesin e dialogut dhe aspekte të ndryshme të normalizimit të marrëdhënieve. "Me institucionet tashmë të konstituuara në Prishtinë, diskutuam për rrugën përpara në dialogun Beograd-Prishtinë dhe aspektet e ndryshme të procesit të normalizimit, të cilat kanë rëndësi për njerëzit në terren dhe për rajonin", thuhet në njoftim.

Zyra e BE-së e cilësoi takimin shkëmbim të mirë të mendimeve, ndërsa theksoi rëndësinë e vazhdimit të procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.





A MUND TA ZHBLLOKOJË DEBATI PËR SPECIALEN RRUGËN E KOSOVËS DREJT KËSHILLIT TË EVROPËS?

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Konsultimet e Kosovës me Bashkimin Evropian për ndryshimet në Ligjin për Dhomat e Specializuara mund të shërbejnë si mundësi për ta rikthyer besimin e partnerëve evropianë dhe për t'i dhënë shtysë anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës - proces ky i bllokuar prej më shumë se dy vjetësh.

Disa njohës të çështjeve evropiane vlerësojnë se mënyra se si Kosova i trajton këto ndryshime, mund të dëshmojë përkushtimin e saj ndaj sundimit të ligjit dhe respektimit të detyrimeve ndërkombëtare - çështje me rëndësi për anëtarësimin në Këshillin e Evropës.

Kosova ishte pranë anëtarësimit në këtë organizatë në vitin 2024, por procesi ngeci për shkak të kërkesave politike të disa shteteve anëtare, kryesisht lidhur me Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.

Ndonëse konsultimet për Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe anëtarësimi në Këshillin e Evropës janë dy procese të ndara, njohësit vlerësojnë se ato janë të lidhura politikisht.

Ramadan Ilazi, nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), thotë se shumë prej shteteve që vendosin për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, janë edhe ato që përcjellin nga afër përmbushjen e detyrimeve të saj ndërkombëtare.

Megjithatë, zgjidhja e mosmarrëveshjes me BE-në për ndryshimet ligjore nuk do të nënkuptonte automatikisht zhbllokimin e anëtarësimit.

Vendimi përfundimtar mbetet në duart e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, ndërsa kërkesat e tyre politike, veçanërisht ato lidhur me Asociacionin, mbeten të pazgjidhura.

Një provë për marrëdhëniet me Evropën

Më 5 nëntor komisionarja evropiane për Zgjerim, Marta Kos, konfirmoi se Bashkimi Evropian po zhvillon bisedime me Qeverinë e Kosovës për ndryshimet në Ligjin për Dhomat e Specializuara, të njohura edhe si Gjykata Speciale.

Qeveria, megjithatë, nuk ka dhënë publikisht hollësi për këto bisedime dhe as nuk u është përgjigjur pyetjeve të Radios Evropa e Lirë për zhvillimin dhe përmbajtjen e tyre.

Kryeministri Albin Kurti, duke folur më 10 nëntor në Forumin e Paqes në Paris, nuk iu referua ndryshimeve ligjore, por tha se pakënaqësitë me aktgjykimin e Gjykatës Speciale duhet të adresohen përmes apelimit.

Ndryshimet në ligj, të iniciuara nga Partia Demokratike e Kosovës, u miratuan në Kuvend më 6 tetor, pas protestave kundër aktgjykimit dënues të shkallës së parë ndaj katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Më 16 shtator Gjykata Speciale në Hagë dënoi për krime lufte ish-presidentin Hashim Thaçi dhe ish-kryeparlamentarin Jakup Krasniqi me nga 25 vjet burgim, ish-kryeparlamentarin Kadri Veseli me 18 vjet dhe ish-deputetin Rexhep Selimi me 13 vjet.

Ndryshimet ligjore synojnë, ndër të tjera, kufizimin e juridiksionit të Gjykatës Speciale dhe ndryshimin e disa dispozitave që lidhen me procedurat dhe dënimet.

BE-ja i kundërshtoi ato, duke paralajmëruar se bien ndesh me detyrimet ndërkombëtare të Kosovës dhe mund të cenojnë pavarësinë e gjykatës.

Më 22 tetor, presidentja e Kosovës Justina Shiroka-Pula e ktheu ligjin në Kuvend për rishqyrtim.

Sipas Rregullores së Kuvendit, komisioni përgjegjës ka katër javë afat nga pranimi i ligjit për ta përgatitur raportin për seancë plenare.

BE-ja e mirëpriti vendimin e presidentes dhe kërkoi të konsultohej për çdo ndryshim të mëtejshëm, në përputhje me shkëmbimin e letrave të vitit 2014 ndërmjet Kosovës dhe BE-së.

Në raportin e 4 nëntorit, edhe Komisioni Evropian paralajmëroi se ndryshimet e propozuara ngrenë shqetësime serioze për detyrimet ndërkombëtare të Kosovës, pavarësinë e gjyqësorit, mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve, si dhe llogaridhënien për krimet e luftës.

Engjëllushe Morina, hulumtuese e lartë për politika në Këshillin Evropian për Marrëdhënie me Jashtë, me bazë në Berlin, paralajmëron se ndryshimet në Ligjin për Dhomat e Specializuara mund të kthehen në pengesën e radhës për Kosovën në rrugën drejt Këshillit të Evropës.

Ajo vlerëson se tani, kur Kosova ka institucione të qëndrueshme, duhet ta intensifikojë bashkëpunimin me BE-në dhe angazhimin diplomatik për integrimin evropian. "Kosova nuk ka më kohë për të humbur. Duke pasur parasysh kontekstin politik në Evropë, gjërat po lëvizin shumë shpejt dhe viti 2027, me zgjedhje nacionale në shumë vende anëtare, mund ta ndryshojë konstelacionin politik në BE. Kjo mund të na çojë në një situatë ku Kosova do të ketë edhe më pak përkrahje", vlerëson Morina për Radion Evropa e Lirë.

Për Ilazin, ndërkaq, konsultimet me BE-në mund të jenë një mundësi për të dëshmuar se Kosova është e gatshme t'i trajtojë shqetësimet e partnerëve evropianë përmes dialogut dhe institucioneve. "Nëse ndryshimet bëhen në mënyrë të njëanshme, rezervat ekzistuese vetëm sa do të forcohen. Nëse kalojnë përmes konsultimeve serioze, Kosova e forcon argumentin e saj" për anëtarësim në Këshillin e Evropës, thotë ai.

Ilazi vlerëson se shqetësimet për mënyrën se si Dhomat e Specializuara e kanë administruar procesin gjyqësor janë legjitime, por se duhet të adresohen përmes dialogut dhe mekanizmave institucionalë, e jo përmes ndryshimeve të njëanshme ligjore. Ky qëndrim u pasqyrua edhe në një deklaratë të përbashkët, të publikuar më 1 nëntor, të cilën Ilazi e nënshkroi bashkë me 20 akademikë, aktivistë dhe përfaqësues të shoqërisë civile nga Kosova dhe jashtë saj.

Në të, nënshkruesit kërkuan që shqetësimet lidhur me proceset gjyqësore në Hagë të trajtohen duke respektuar njëkohësisht të drejtat e të akuzuarve, drejtësinë për viktimat dhe detyrimet ndërkombëtare të Kosovës.

Ilazi thotë se drejtësia për viktimat nuk duhet të krijojë përshtypjen se po gjykohet vetë lufta çlirimtare, ndërsa thekson se viktimat dhe familjet e tyre, nga të gjitha komunitetet, meritojnë të vërtetën dhe llogaridhënien. "Këto parime duhet të respektohen së bashku dhe pa diskriminim. Ky është edhe mesazhi që Kosova duhet t'i dërgojë Këshillit të Evropës", thotë ai.

Sipas tij, trajtimi i çështjeve të ndjeshme përmes institucioneve, ekspertizës dhe dialogut do të ishte një mesazh i rëndësishëm për Strasburgun dhe kryeqytetet evropiane.

Asociacioni, pengesa që mbetet

Përtej debatit për Gjykatën Speciale, një tjetër pengesë politike vazhdon ta mbajë pezull anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës: Asociacioni i komunave me shumicë serbe.

Më 16 prill 2024, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës rekomandoi pranimin e Kosovës, me 131 vota për, 29 kundër dhe 11 abstenime.

Por, një muaj më vonë, aplikimi i saj nuk u përfshi në rendin e ditës të takimit të Komitetit të Ministrave - organit që merr →

KUSH ËSHTË MIKHAIL BOGACHEK, I NOMINUARI I TRUMPIT PËR AMBASADOR TË SHBA-SË NË KOSOVË?

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Presidenti amerikan Donald Trump ka nominuar Mikhail Bogachekun për ambasador të ri të Shteteve të Bashkuara në Kosovë, duke ia dërguar emrin Senatit amerikan për konfirmim. Nominimi i tij është bërë përmes një njoftimi të publikuar në faqen zyrtare të Shtëpisë së Bardhë më 10 nëntor.
Ambasada Amerikane në Prishtinë aktualisht udhëhiqet nga e ngarkuara me punë, Anu Prattipati, pasi ambasadori paraprak, Jeff Hovenier, përfundoi mandatin e tij trevjeçar në fund të dhjetorit të vitit 2024.

Kush është Mikhail Bogachek?

Michael Bogachek aktualisht mban pozitën e drejtorit ekzekutiv në Organizatën e Shteteve Amerikane (OAS), ku mbikëqyr operacionet administrative, financat, prokurimin, burimet njerëzore dhe teknologjinë informative, sipas një biografie të publikuar në faqen e organizatës.
OAS-i, i themeluar në vitin 1948, përfshin 35 shtete të kontinentit amerikan dhe ka për qëllim forcimin e demokracisë, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sigurinë dhe zhvillimin.
Sipas biografisë së tij, Bogachek ka mbi 25 vjet përvojë në sektorët e shëndetësisë, teknologjisë dhe menaxhimit institucional. Më herët ai ka qenë drejtor operativ në kompaninë "VativoRx", e cila merret me administrimin e përfitimeve farmaceutike në ShBA. Ai ka themeluar edhe kompaninë "Cooperton", e specializuar në sigurinë kibernetike dhe menaxhimin e krizave, si dhe kompaninë "PharmaLife", që merret me teknologjinë në sektorin farmaceutik.
Bogachek ka diplomuar në inxhinieri industriale dhe të sistemeve në Institutin e Teknologjisë të Xhorxhias dhe ka doktoraturë në Bioinxhinieri. Ai ka përfunduar, gjithashtu, një program për drejtues biznesesh në Shkollën e Biznesit të Harvardit.
Flet rrjedhshëm gjuhën ruse, ukrainase dhe hebraike.
Nominimi për ambasador në Kosovë është pjesë e një liste më të gjerë emërimesh, të dërguar nga administrata Trump në Senat, më 10 nëntor.

Nominimi mes sfidave në marrëdhëniet Kosovë - ShBA

Nominimi i Bogachekut vjen në një periudhë kur marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara janë përballur me sfida, përfshirë pezullimin e Dialogut Strategjik nga Uashingtoni në vitin 2025.
ShBA-ja e pezulloi këtë dialog, duke shprehur shqetësime për veprimet e qeverisë së atëhershme në detyrë ndaj institucioneve serbe në Kosovë dhe kritikat e saj ndaj Gjykatës Kushtetuese, të cilat, sipas Uashingtonit, kishin rritur tensionet dhe kishin kufizuar mundësitë për bashkëpunim në prioritetet e përbashkëta.
Në korrik të këtij viti Departamenti Amerikan i Shtetit i tha REL-it se rifillimi i dialogut varet nga krijimi i kushteve të nevojshme, përfshirë përmbushjen e zotimeve të Kosovës ndaj serbëve.
Më herët gjatë këtij viti, administrata Trump nominoi ambasadorë edhe për Shqipërinë, Serbinë, Bosnjë-Hercegovinën dhe Malin e Zi.
Senati amerikan e konfirmoi Eric Wendtin ambasador në Shqipëri më 7 gusht, ndërsa kandidatët për tri vendet e tjera ende janë në pritje të konfirmimit.



vendimin përfundimtar për anëtarësimin.
Disa shtete anëtare, përfshirë Gjermaninë dhe Francën, kërkuan që Kosova ta dërgonte për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese draft-statutin e Asociacionit, të përgatitur nga BE-ja, si dëshmi të përkushtimit ndaj marrëveshjeve të arritura në dialogun me Serbinë.
Qeveria e Kosovës fillimisht e kundërshtoi kërkesën. Më pas, ministrja e atëhershme e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, njoftoi se kishte dërguar një letër në Këshillin e Evropës, duke paralajmëruar dërgimin e draft-statutit në Gjykatën Kushtetuese deri në fund të majit 2024.
Por, kjo nuk mjaftoi për ta zhbllokuar procesin.
Sipas Ilazit, kërkesa për Asociacionin nuk ishte kriter formal për anëtarësim, por kusht politik i disa shteteve anëtare.
Ai vlerëson se rekomandimi pozitiv i Asamblesë Parlamentare kishte dëshmuar se Kosova i plotësonte standardet kryesore për pranim. "Pra, sot problemi nuk është se Kosova është e papërgatitur. Problemi është mungesa e besimit politik. Ky besim mund të ndërtohet, por kërkon punë të vazhdueshme dhe të koordinuar", thotë Ilazi.
Nuk ka konfirmim publik se shtetet që e vendosën Asociacionin si kusht politik, kanë hequr dorë nga kjo kërkesë.
Radio Evropa e Lirë i është drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës për të pyetur nëse Asociacioni mbetet kusht për anëtarësim dhe çfarë hapash kërkohen për sigurimin e mbështetjes së shteteve anëtare.
Nga Këshilli i Evropës ka kërkuar sqarime për kushtet e mbetura dhe mundësinë e shqyrtimit të aplikimit në takimin e ardhshëm ministror.
Asnjëri institucion nuk është përgjigjur deri në publikimin e artikullit. Sipas Morinës, kushti i Asociacionit "është ende aty", ndërsa mbetet të shihet se si do ta trajtojë Kosova këtë çështje në dialogun me Serbinë.
Edhe Ilazi thotë se për disa shtete evropiane Asociacioni mbetet tregues i gatishmërisë së Kosovës për t'i përmbushur detyrimet e marra në dialog. Ai vlerëson se dërgimi i draft-statutit në Gjykatën Kushtetuese nuk duhet të shihet si lëshim politik, por si një mekanizëm për të garantuar përputhshmërinë e çdo zgjidhjeje me rendin kushtetues të Kosovës.
"Është procedurë kushtetuese që e mbron vetë Kosovën, sepse Gjykata garanton se çdo zgjidhje do të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe me karakterin unitar të shtetit. Kosova duhet ta bëjë këtë hap, por jo në heshtje dhe jo si veprim të izoluar", thekson Ilazi. Sipas tij, Kosova duhet të sigurojë paraprakisht garanci politike nga partnerët kryesorë evropianë dhe Shtetet e Bashkuara se një hap i tillë do t'i hapte rrugën shqyrtimit të aplikimit të saj.

A mund të jetë viti 2027 një mundësi e re?

Më 10 nëntor Mali i Zi mori kryesimin gjashtëmujor të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, duke pasuar Monakon.
Kryesimi i tij do të përmbyllet më 12 maj 2027, kur është planifikuar të mbahet takimi i ardhshëm vjetor ministror në Mal të Zi.
Por, ende nuk ka konfirmim se aplikimi i Kosovës do të përfshihet në rendin e ditës së këtij takimi.
Për pranimin e një anëtari të ri, Komiteti i Ministrave duhet të sigurojë mbështetjen e dy të tretave të të gjithë përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë në këtë organ, sipas Statutit të Këshillit të Evropës. Kjo do të thotë se, përveç përmbushjes së standardeve të kërkuara, Kosovës i nevojitet edhe mbështetje e gjerë politike nga shtetet anëtare.
Për Ilazin, përfshirja e aplikimit në agjendën e vitit 2027 kërkon angazhim të koordinuar diplomatik dhe hapa konkretë në raport me partnerët evropianë. "Kjo kërkon tri gjëra: përmirësim të marrëdhënieve me BE-në, përfshirë një zgjidhje të konsultuar për ligjin e Dhomave të Specializuara, hapa të besueshëm në dialog dhe një fushatë diplomatike të koordinuar me shtetet që hezitojnë", thotë ai.
Anëtarësimi në Këshillin e Evropës do t'i hapte Kosovës rrugën drejt sistemit evropian të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfshirë mundësinë që individët nën juridiksionin e saj t'i drejtoheshin Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

A PO E RRIT INTELIGJENCA ARTIFICIALE RREZIKUN NGA SULMET KIBERNETIKE?

Prishtinë, 11 nëntor - Në disa vende të Evropës, nga Suedia deri në Belgjikë, sulmet kibernetike prekën sistemet e ftohjes në supermarkete, duke rritur temperaturat në frigoriferë. Kur lidhen me internetin, pajisje si frigoriferët dhe kamerat e sigurisë mund të sulmohen nga distanca.

Blerim Rexha, profesor i inxhinierisë kompjuterike në Universitetin e Prishtinës, thotë se shumë prej këtyre pajisjeve fillimisht nuk ishin projektuar për t'u kontrolluar nga distanca. Vetëm më vonë u janë shtuar module që mundësojnë kontrollin përmes internetit. "Në momentin që pajisjen tonë e ekspozojmë në internet, ne duhet paraprakisht t'i marrim të gjitha masat që diçka e tillë të mos ndodhë nga personat e paautorizuar", shpjegon ai në podkastin 5 pyetje të Radios Evropa e Lirë.

Një nga dobësitë e këtyre pajisjeve, sipas Rexhës, janë fjalëkalimet e paracaktuara nga prodhuesit. "Shumica e këtyre pajisjeve, nëse janë të ekspozuara në internet, kanë kredencialet të cilat njihen si "default", "admin123" e kështu me radhë dhe për pasojë janë lehtë të hakueshme", thotë ai.

Në përgjithësi Rexha thotë se inteligjenca artificiale po ua mundëson edhe personave me më pak njohuri teknike të kryejnë sulme kibernetike që më parë kërkonin ekspertizë të avancuar. "Derisa para katër, pesë e më shumë viteve për të sulmuar duhej të kishte një inxhinier jashtëzakonisht të mirë që i njeh sistemet, sot me inteligjencën artificiale ky prag është zvogëluar jashtëzakonisht shumë kështu që edhe fillestarët edhe grupet që nuk kanë një buxhet të mjaftueshëm mund të bëjnë diçka të tillë", thotë ai.

Identifikimi i autorëve mbetet një nga vështirësitë e hetimit. Sipas Rexhës, sulmuesit përpiqen t'i fshehin gjurmët digjitale dhe, në disa raste, veprojnë nga shtete të tjera.

Mashtrimet bankare bëhen më bindëse me IA

Në supermarketet evropiane sulmet prekën sistemet e ftohjes. Në Kosovë mashtruesit kanë përdorur mesazhe të rreme për të vjedhur të dhënat bankare të qytetarëve.

Dhjetëra qytetarë kanë rënë viktimë e mesazheve që dukeshin sikur vinin nga bankat e tyre. Mesazhet i drejtonin në faqe që imitonin ato të bankave, ku



mashtruesit u merrnin të dhënat dhe më pas ua zbraznin llogaritë. Mesazhe të tilla mund të duken sikur vijnë edhe nga posta ose institucione të tjera.

Rexha shpjegon se inteligjenca artificiale mund t'i bëjë këto mesazhe më bindëse, duke u dhënë një gjuhë më të natyrshme dhe një pamje që imiton komunikimet zyrtare. "Nuk tingëllojnë vetëm përkthime bukfale nga gjuha angleze, por tani duken jashtëzakonisht të përafërta, sikur një mik i yni, sikur dikush i afërt ose sikur banka jonë tani ka dërguar një e-mail", thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Pasojat e vjedhjes së të dhënave personale mund të shkojnë përtej humbjes së parave nga llogaritë bankare. Sipas Rexhës, të dhënat për individë dhe grupe të caktuara shiten në tregje të paligjshme në internet. Ai paralajmëron se këto të dhëna mund të përdoren edhe për të krijuar identitete të rreme, një rrezik që e veçon në kohën kur Kosova po kalon drejt shërbimeve dhe identifikimit digjital.

Kosova ka ligje për sigurinë kibernetike, por ngecën në zbatimin e tyre

Sipas Rexhës, zbatimi i ligjeve mbetet sfida kryesore për institucionet e Kosovës në përgatitjen për sulme kibernetike që mund të bllokojnë shërbimet publike. "Ne mburremi që pasuria jonë janë njerëzit, por nuk i kemi mbështetur mjaftueshëm. Prandaj Kosova nuk ngec në aspektin ligjor, po ngec në aspektin praktik", thotë ai.

"Investimi kryesor në këtë drejtim duhet bërë te të rinjtë, te studentët, sepse ata janë aseti kryesor, jo teknologjia, jo pajisjet që i blejmë", thekson ai.

Për qytetarët, thotë Rexha, mbrojtja nis duke mësuar si t'i përdorin në mënyrë të sigurt pajisjet e lidhura me internetin, si kondicionerët që kontrollohen përmes telefonit, dhe si t'i dallojnë mesazhet mashtruese. Ai propozon që siguria kibernetike të mësohet që në shkollën fillore dhe që qytetarëve t'u ofrohen trajnime. Sipas tij, përgjegjësia për sigurinë kibernetike ndahet mes ekspertëve të teknologjisë, institucioneve shtetërore, shkollave, universiteteve, kompanive dhe vetë qytetarëve.

IKD-ja KËRKON NGA MINISTRIA E DREJTËSISË TA ZGJATË AFATIN E KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTKODIN CIVIL

Prishtinë, 11 nëntor - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka shprehur shqetësimin lidhur me afatin e shkurtër të konsultimit publik për Projektkodin Civil të Republikës së Kosovës.

Ministria e Drejtësisë (MD) ka publikuar këtë dokument për konsultim publik më 27 tetor 2026, duke caktuar 16 nëntorin 2026 afat përfundimtar për dorëzimin e komenteve. Kështu, për një nga aktet më të rëndësishme dhe më voluminoze të sistemit juridik të Kosovës, janë lënë në dispozicion vetëm 15 ditë pune për konsultim publik.

Projektkodi Civil përmban gjithsej 1 630 nene dhe synon të rregullojë pothuajse të gjitha marrëdhëniet themelore juridike civile, përfshirë marrëdhëniet e detyrimeve, pronësinë, familjen dhe trashëgiminë. Për nga rëndësia, përmbajtja dhe vëllimi, ky dokument nuk mund të trajtohet njësoj sikurse projektet e zakonshme. Shqyrtimi i tij kërkon analizë të thelluar juridike, krahasim me legjislacionin ekzistues, standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare, si dhe vlerësim të pasojave praktike që dispozitat e propozuara do të prodhojnë për qytetarët dhe institucionet.

IKD-ja vlerëson se afati i përcaktuar nga MD-ja është objektivisht i pamjaftueshëm për një konsultim cilësor dhe gjithëpërfshirës. "Nuk mund të pritet që profesionistët juridikë, institucionet e drejtësisë, universitetet, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e tjera të interesit të analizojnë në mënyrë substanciale 1,630 nene brenda një afati kaq të shkurtër. Sipas nenit 51, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, të Rregullores (QRK) nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë, për akte veçanërisht komplekse ose të rëndësishme, afati për dërgimin e komenteve mund të zgjatet deri në 30 ditë kalendarike. Për më tepër, neni 52, paragrafi 1.1, i kësaj rregulloreje i mundëson organit propozues zgjatjen e afatit apo ripërsëritjen e konsultimit publik kur natyra e materialit kërkon kohë më të gjatë për konsultim. Projektkodi Civil padyshim përmbush kriteret e një akti veçanërisht kompleks dhe të rëndësishëm. Për këtë arsye, IKD i kërkon MD-së që ta zgjasë afatin e konsultimit publik në të paktën 30 ditë kalendarike", thuhet në reagimin e IKD-së.

Megjithatë, IKD-ja vlerëson se edhe afati prej 30 ditësh kalendarike është i pamjaftueshëm për konsultimin e mirëfilltë të një kodi me 1,630 nene. "Në këtë drejtim, shqetësuese është se Rregullorja aktuale ka shënuar regres në raport me standardin e mëparshëm. Konkretisht, neni 9, paragrafi 1.2, i Rregullores (QRK) nr. 05/2016 për Standardet



Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, parashihte mundësinë e zgjatjes së konsultimit deri në 60 ditë kalendarike për akte veçanërisht komplekse ose të rëndësishme. Me Rregulloren e vitit 2024, kjo mundësi është përgjysmuar në vetëm 30 ditë kalendarike. Një kufizim i tillë nuk i shërben përfshirjes substanciale të publikut, veçanërisht gjatë hartimit të legjislacionit kompleks", theksohet në reagim.

IKD-ja konsideron se kjo situatë është edhe pasojë e mungesës së planifikimit të mirëfilltë legjislativ. "Ministria e Drejtësisë ka pasur mundësi që, përmes një planifikimi më të mirë, ta publikojë më herët Projektkodin Civil dhe të sigurojë kohë të mjaftueshme për konsultim. Vonesat në planifikimin dhe publikimin e dokumentit nuk duhet të kompensohen duke ua kufizuar kohën qytetarëve dhe palëve të interesit për dhënien e komenteve, kufizim ky që ndikon direkt në cilësinë e Projektkodit Civil. Për më tepër, shqetësuese është mospërputhja ndërmjet Programit të Projektligjeve të Qeverisë dhe afatit të konsultimit publik. Në programin e miratuar më 6 tetor 2026, Qeveria ka përcaktuar 15 nëntorin si afat për Projektkodin Civil, ndërkohë që Ministria e Drejtësisë e ka hapur konsultimin publik deri më 16 nëntor. Është e pakuptimtë që të planifikohet procedimi i një akti përpara përfundimit të konsultimit të tij publik", është bërë me dije në reagimin e IKD-së.

IKD-ja ka theksuar se mbështet nevojën për miratimin sa më të shpejtë të Kodit Civil, përfshirë përmbushjen e obligimeve që burojnë nga Agjenda e Reformave. "Megjithatë, afatet e përcaktuara në programet qeveritare apo në angazhimet ndërkombëtare nuk duhet të shërbejnë si arsyetim për kufizimin e konsultimeve publike dhe cenimin e cilësisë së legjislacionit. Miratimi i nxituar i një kodi të kësaj rëndësie mund të prodhojë dispozita të paqarta, kundërthënëse dhe probleme afatgjata në zbatimin e tyre", theksohet tutje në reagim.

IKD-ja i bën thirrje Ministrisë së Drejtësisë ta zgjatë afatin e konsultimit publik për Projektkodin Civil në të paktën 30 ditë kalendarike, të sigurojë shqyrtim substancial të komenteve dhe të organizojë diskutime gjithëpërfshirëse me profesionistët dhe institucionet relevante.

Njëkohësisht, IKD-ja i kërkon qeverisë ta harmonizojë programin legjislativ me procedurat e detyrueshme dhe ta rishqyrtojë kufizimin prej 30 ditësh për konsultimin e akteve veçanërisht komplekse. Sipas IKD-së, Kosova ka nevojë për Kodin Civil, mbi të gjitha ka nevojë për një Kod Civil cilësor, të harmonizuar dhe të zbatueshëm. "Cilësia e një reforme kaq të rëndësishme nuk duhet të sakrifikohet për përmbushjen e afateve të përcaktuara nga vetë qeveria", theksohet në reagimin e IKD-së.

ÇFARË ËSHTË SEPA, KU KOSOVA KA APLIKUAR PËR ANËTARËSIM?

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Kosova ka aplikuar për anëtarësim në Zonën e Vetme të Pagesave në Euro (SEPA) dhe, nëse vendi përfshihet në këtë zonë, atëherë qytetarët dhe bizneset do të kursenin para gjatë transfereve.

SEPA është një nismë e Bashkimit Evropian që u mundëson njerëzve dhe bizneseve të kryejnë pagesa në euro në mënyrë të sigurt, të shpejtë dhe me tarifa të barabarta në të gjitha vendet anëtare.

Çfarë përfiton Kosova?

Banka Qendrore e Kosovës tha mbrëmjen e 6 nëntorit se aplikimi për anëtarësim në SEPA përbën një hap të rëndësishëm të integrimit financiar dhe ekonomik të vendit me BE-në - bllok ku Kosova synon që një ditë të bëhet anëtare.

Sipas BQK-së, nëse Kosova përfshihet në hapësirën gjeografike të SEPA-s, një gjë e tillë do të sillte kursime prej rreth 55 milionë eurosh për qytetarët dhe bizneset në vit.

Ekspertët e fushës së financave kanë thënë më herët për Radion Evropa e Lirë se anëtarësimi në SEPA do të kishte ndikim pozitiv për të gjithë. "Qytetarët që pranojnë remitenca apo transfere të tjera do t'u nënshtrohen tarifave shumë më të lira. Transferet hyrëse dhe dalëse do të jenë më të shpejta, më të sigurta dhe më të lehta për t'u realizuar", sipas ekspertit financiar, Nexhat Miftari.

Qytetarët e Kosovës, që jetojnë jashtë vendit, dërgojnë remitenca për familjarët e tyre dhe vlera e dërgesave arrin deri mbi 1 miliard euro në vit.

Një qytetar i Kosovës, që punon në Gjermani i ka thënë më herët Radios Evropa e Lirë se paratë për familjen e tij në Kosovë i dërgon vetëm përmes kompanive të transferimit të parave, e jo bankave, për shkak të tarifave të larta.

Shuma që duhet të paguhet për komisione varet nga vlera e parave të transferuara, nga valuta por edhe nëse dërguesi është individ apo biznes. REL-i raportoi më 2025, se kostot minimale për transfere ndërkombëtare varionin nga 15 deri mbi 500 euro, në varësi të shumës, valutës dhe llojit të klientit.

Kostot e transfereve, por edhe koha, do të uleshin ndjeshëm me përfshirjen eventuale të Kosovës në SEPA.

Një shembull të ndikimit të anëtarësimit të një vendi në këtë zonë e dha kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, kur vendi i tij u pranua në këtë zonë vitin e kaluar.

Sipas tij, komisionet për transfere bankare u ulën pas pranimit në SEPA në 1 deri në 3 euro për shuma prej 100 deri në 500 euro. Para anëtarësimit, marrësi në Shqipëri merrte 88-90 euro, pasi bankat mbanin deri në 10 për qind të shumës. "Standardet e harmonizuara në të gjitha vendet e SEPA-s kanë eliminuar dallimet mes pagesave brenda vendit dhe atyre ndërkufitare. Kjo ka ndihmuar në rritjen e efikasitetit dhe konkurrueshmërisë së ekonomisë evropiane", thuhet në ueb-faqen e Bankës Qendrore Evropiane lidhur me nismën SEPA.

Tani, aplikimi i Kosovës duhet t'i nënshtrohet procedurave të vlerësimit dhe përputhshmërisë me kornizën ligjore dhe rregullative me kërkesat për përfshirje në hapësirën gjeografike të SEPA-s, dhe sipas BQK-së, pas "një vendimi pozitiv, do të vijojnë procedurat për pjesëmarrjen e institucioneve financiare të Kosovës në skemat përkatëse të pagesave".



Si erdhi deri tek aplikimi?

Qysh në tetor të vitit 2024, Kosova nisi procedurën për t'u anëtarësuar në SEPA, kur edhe dorëzoi paraaplikimin. Kjo fazë, sipas BQK-së, mundësoi nisjen e konsultimeve dhe vlerësimeve paraprake me institucionet përkatëse evropiane.

"Që nga ajo periudhë, BQK-ja ka vazhduar punën për adresimin e kërkesave, përgatitjen e dokumentacionit dhe përmbushjen e kushteve ligjore, rregullative dhe teknike", tha BQK-ja në njoftimin për media.

Megjithatë, për të dorëzuar aplikimin, Kosovës iu desh që paraprakisht të përafronte legjislacionin me kërkesat e BE-së.

Në këtë kuadër u kërkuan tri ligje të rëndësishme, ai për bankat, për shërbimet e pagesave dhe të bëheshin ndryshimet në legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit. Ato ligje ishin dërguar për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, pas ankesës për shkelje të procedurave gjatë miratimit.

Gjykata kishte shpallur jokushtetues Ligjin për shërbimet e pagesave – për shkak të shkeljeve procedurale gjatë miratimit të tij. Por, Kushtetuesja vendosi që ai për bankat ishte në përputhje me aktin më të lartë juridik.

Më vonë deputetët miratuan Ligjin për shërbimet e pagesave dhe votuan për ndryshimet në legjislacionin për pastrimin e parave dhe luftimin dhe financimin e terrorizmit, duke i hapur rrugë aplikimit për përfshirje në SEPA.

BQK-ja tha se pas dorëzimit të aplikimit do të vazhdojë të bashkëpunojë me institucionet evropiane, me bankat komerciale si dhe me ofruesit e tjerë të shërbimeve të pagesave me qëllim që të bëhen përgatitjet teknike dhe operacionale që kërkohen për integrimin e plotë në skemat e SEPA-s.

Në SEPA aktualisht janë 41 vende, përfshirë të gjitha vendet anëtare të BE-së, por edhe vende joanëtare sikurse Zvicra, Mbretëria e Bashkuar, por edhe vendet fqinje të Kosovës.

Diskutohen mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe IRI-t

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Justina Shiroka-Pula, priti në takim drejtorin e lartë për Evropë dhe Euroazi në Institutin Republikan Ndërkombëtar (IRI), Stephen B. Nix, me të cilin diskutoi për zhvillimin demokratik të Kosovës dhe bashkëpunimin shumëvjeçar me këtë institut.

Presidentja Shiroka-Pula vlerësoi kontributin e IRI-së për avancimin e demokracisë dhe forcimin e institucioneve demokratike në Kosovë, veçanërisht në mbështetjen për partitë politike, përmirësimin e organizimit të tyre dhe zhvillimin e komunikimit me qytetarët. Ajo çmoi bashkëpunimin me Kuvendin dhe angazhimin për fuqizimin e grave në politikë dhe në vendimmarrje.

Duke folur për zhvillimet në vend, presidentja theksoi se konsolidimi i demokracisë kërkon institucione funksionale, respektim të ndarjes së pushteteve, pavarësi të gjyqësorit dhe përgjegjësi institucionale. Ajo nënvizoi rëndësinë e ruajtjes së rendit kushtetues, respektimit të kompetencave të secilit institucion dhe forcimit të besimit të qytetarëve në institucionet e vendit.

Në takim u diskutua edhe për mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe IRI-t, me fokus në edukimin demokratik, luftimin e dezinformimit, promovimin e debatit politik, si dhe për çështje që ndërlidhen me sigurinë rajonale dhe perspektivën euroatlantike të Kosovës.



BERZH-i VLERËSON PUNËN PËR AVANCIMIN E INTEGRIMIT TË BURIMEVE TË RIPËRTËRISHME NË SISTEMIN ENERGJETIK

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Zëvendësministri i Ekonomisë, Getoar Mjeku, së bashku me shefen e kabinetit, Anyla Beqa, pritën në takim drejtorin menaxhues të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) për Evropën Juglindore, Grzegorz Zielinski, i shoqëruar nga delegacioni i BERZh-it. Kjo ishte vizita e parë e Zielinskit në Kosovë që nga emërimi i tij në këtë pozitë më 1 qershor 2026.

Takimi shërbeu si një mundësi e rëndësishme për të diskutuar për prioritetet e sektorit të energjisë dhe mënyrat se si BERZh-i mund të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në shndërrimin e këtyre prioriteteve në projekte konkrete.

Gjatë takimit u vlerësua partneriteti i deritanishëm ndërmjet Kosovës dhe BERZh-it si dhe u diskutuan mundësitë për thellimin e bashkëpunimit në projekte kyçe të tranzicionit energjetik.

BERZh-i vlerësoi punën e deritanishme në avancimin e integrimit të burimeve të ripërtërishme në sistemin energjetik dhe shprehu interesim për t'i mbështetur projektet që lidhen me hartimin dhe zbatimin e ankandeve për energjinë e ripërtërishme, me qëllim rritjen e kapaciteteve vendore të energjisë së pastër dhe forcimin e sigurisë energjetike të vendit.



Palët diskutuan gjithashtu për zbatimin e projekteve të efiçiencës së energjisë dhe zgjerimin e mundësive të financimit për qytetarët dhe bizneset përmes linjave kreditore të ofruara në bashkëpunim me institucionet financiare vendore. Në këtë kontekst, u diskutua edhe mbështetja për programe të financimit të gjelbër, që lehtësojnë investimet në teknologji të pastra dhe masa të efiçiencës së energjisë.

Zëvendësministri Mjeku falënderoi BERZh-in për mbështetjen ndaj sektorit të energjisë të Kosovës dhe theksoi rëndësinë e partneritetit me institucionet financiare ndërkombëtare në përshpejtimin e tranzicionit drejt energjisë së pastër, rritjen e efiçiencës së energjisë dhe krijimin e mundësive të reja për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Të dyja palët shprehën gatishmërinë për të bashkëpunuar për realizimin e projekteve strategjike, që mbështesin objektivat e Kosovës për një sektor të energjisë më të qëndrueshëm, më konkurrues dhe më të integruar me tregjet evropiane.

ASK: NË KOSOVË KISHTE 48 MIJË E 506 NDËRMARRJE AKTIVE GJATË VITIT 2025, SHËNOHET RËNIE PREJ 4-PËRQINDËSH



EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve (ASN) për vitin 2025, sipas të cilave, në Kosovë ishin gjithsej 48 506 ndërmarrje aktive në sektorët ekonomikë të përfshirë në hulumtim. Sipas ASK-së, numri i ndërmarrjeve aktive ka shënuar rënie prej 4-përqindësh krahasuar me vitin 2024. Megjithatë, rritje është regjistruar në sektorin e furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar, ku numri i ndërmarrjeve është rritur për 30,1 për qind.

Ndërkaq numri i përgjithshëm i të punësuarve në këta sektorë ka arritur në 294 254, duke shënuar rritje prej 0,4-përqindësh krahasuar me vitin paraprak. Rënie e punësimit është evidentuar në sektorin e ndërtimtarisë, 11,1 për qind.

Sa i përket qarkullimit, ndërmarrjet në Kosovë kanë realizuar rritje prej 6,1-përqindësh gjatë vitit 2025 krahasuar me vitin 2024. Rritja më e madhe e qarkullimit sipas sektorëve është shënuar në shërbimet e tjera, 13,9 për qind.

Rritje është regjistruar edhe te pagat mesatare, të cilat kanë shënuar normë rritjeje prej 11,1-përqindësh. Sipas të dhënave të ASK-së, paga mesatare bruto në sektorët e përfshirë në anketë ka arritur në 658 euro në vitin 2025, nga 354 euro sa ishte në vitin 2015.

Paga mesatare më e lartë është regjistruar në sektorin e furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar, ndërsa më e ulëta në sektorin e akomodimit dhe shërbimeve me ushqim.

Në anën tjetër shpenzimet e ndërmarrjeve kanë shënuar rritje prej 6,6-përqindësh gjatë vitit 2025.

Sipas shpërndarjes së ndërmarrjeve në sektorët ekonomikë, pjesën më të madhe e përbën tregtia me shumicë dhe pakicë, me 33,7 për qind. Pas saj renditen aktivitetet e shërbimeve të tjera me 22,1 për qind, prodhimi me 14,6 për qind, ndërtimtaria me 11,2 për qind dhe akomodimi e shërbimet me ushqim 10,3 për qind.

Ndërsa sa i përket punësimit, tregtia prin me 32,4 për qind të të punësuarve, e ndjekur nga prodhimi me 17,8 për qind, shërbimet e tjera me 15,4 për qind dhe ndërtimtaria me 10 për qind.

ASK bën me dije se pjesën më të madhe të qarkullimit të ndërmarrjeve e përbën sektori i tregtisë, me rreth 51,7 për qind. Përqindjen më të vogël e kanë xehetaria dhe gurëthyesit, me 0,7 për qind, si dhe furnizimi me ujë, kanalizimi dhe menaxhimi i mbeturinave, me 0,6 për qind.

Anketa nuk përfshin sektorët e bujqësisë, pylltarisë, peshkimit, financave, arsimit, shëndetësisë, aktiviteteve të ekonomive familjare dhe administratës publike.

Takohen drejtuesit e BQK-së dhe BERZh-it, në fokus reformat në sektorin financiar

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, priti në takim Grzegorz Zielinski, drejtor menaxhues për Evropën Juglindore i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), i cili shoqërohej nga drejtor i BERZh-it për Kosovën, Sergiy Maslichenko.

Në takim u diskutuan reformat kryesore në sektorin financiar të Kosovës dhe bashkëpunimi ndërmjet BQK-së dhe BERZh-it në zbatimin e tyre.

Vëmendje e veçantë iu kushtua asistencës teknike të BERZh-it për hartimin e rregulloreve që rrjedhin nga Ligji për Bankat dhe zbatimin e kornizës për rimëkëmbjen dhe përmbylljen e bankave. Bashkëbiseduesit diskutuan edhe për projektin e mbështetur nga BERZh-i për përafrimin e mëtejshëm të kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse bankare me standardet e Bashkimit Evropian, në funksion të integrimit financiar evropian të Kosovës.

Në kuadër të bashkëpunimit për zgjerimin e qasjes në financa, u vlerësua nisma "WE Finance Code", të cilën BQK-ja e koordinon në nivel vendi me mbështetjen e BERZh-it për ta përmirësuar qasjen në financa për gratë ndërmarrëse.

U diskutua edhe për mbështetjen e BERZh-it për



nismat mjedisore, përfshirë financimin e gjelbër, si dhe për forcimin e kapaciteteve profesionale të BQK-së në fusha të specializuara, ndër to tregjet e kapitalit.

Bashkëbiseduesit diskutuan edhe për mbështetjen e BERZh-it për projektet në sektorin financiar dhe ato publike infrastrukturore në Kosovë dhe kontributin e këtyre projekteve në zhvillimin ekonomik të vendit.

Guvernatori Ismaili e falënderoi Zielinskin për mbështetjen e vazhdueshme të BERZh-it ndaj Kosovës dhe vlerësoi bashkëpunimin e shkëlqyer të BQK-së me Zyrën e BERZh-it në Kosovë.

NA VJEN KEQ, FEMINISTE - KY MONARK I MADH I EPOKËS SË HEKURIT MBASE NUK ISHTE GRUA

Një studiues pretendon se Verika ishte "padiskutueshëm" grua, por provat çojnë në drejtimin tjetër





Nga: Levi ROACH /
The Telegraph

Këtë javë u zgjuam me lajmin se arkeologët e Universitetit të Bornmuthit kishin bërë një zbulim befasues: sundimtari i famshëm kelt Verika ishte në të vërtetë grua! Sipas Dr. Miles Russellit, i cili udhëhoqi kërkimin: "Verika jo vetëm që ishte vendimtare për marrëdhënien e veçantë mes Britanisë dhe Romës në shekullin I pas Krishtit, por ishte padiskutueshëm grua",

Ky është një pretendim i madh, me pasoja të rëndësishme për historinë e ishullit tonë. Fatkeqësisht, prova "e padiskutueshme" e paraqitur nga Dr. Russell është shumë larg asaj që do të nevojitej për ta vërtetuar këtë.

Në thelb, teza e tij përbëhet nga dy fakte. I pari është forma e emrit të Verikës, siç gjendet në monedhat e tij. Në keltishten e hershme, emrat e burrave zakonisht mbarojnë me -os, -is ose -rix. Një mbaresë me -a, si te Verika, mund të tregojë se bartësi i emrit ishte grua. Diçka e ngjashme vlen edhe për latinishten, gjuhën në të cilën ishin shkruar mbishkrimet në monedhat e Verikës. Këtu, emrat e burrave zakonisht mbarojnë me -us, -ius ose -er, ndërsa emrat e grave shpesh mbarojnë me -a (p.sh. Klaudi-us kundrejt Klaudia-s).

E dyta është se disa prej këtyre monedhave mbajnë figurën e një gruaje mbi kalë, në të njëjtën anë ku ndodhet edhe emri i Verikës. Kësaj mund t'i shtohet edhe një pikë më e gjerë për rolin e rëndësishëm që luanin gratë në shoqërinë britanike të Epokës së Hekurit, rol që ndonjëherë mund të përfshinte edhe marrjen e pozitave udhëheqëse (siç shohim më vonë me Budikën).

Përtej këtyre copëzave të informacionit, ka fare pak mbi të tjera te të cilat mund të mbështetet një hipotezë kaq e gjerë. Njohuritë tona për praktikat e hershme kelte të emërtimit janë larg së qenit të përsosura, por sigurisht ka burra galë që mbanin emra me temë në -a, ku do të bënte pjesë edhe Verika. Kishte gjithashtu një numër të vogël, por domethënës, emrash latinë të burrave që mbaronin me -a, përfshirë Agripa dhe Sula.

Ikonografia e monedhave të Verikës është po aq e hapur ndaj interpretimeve të tjera. Imazhet në monedhat e lashta dhe mesjetare nuk kishin gjithmonë për qëllim të paraqisnin sundimtarin e përmendur me emër. Edhe kur e bënin këtë, ato synonin më pak të ishin riprodhime besnike të pamjes së tij sesa përmbledhje simbolike të autoritetit të individit.

Prandaj, ekziston një rrezik i konsiderueshëm në nxjerrjen e përfundimeve për pamjen e një sundimtari mbi bazën e monedhave të tij. Në rastin e Verikës, disa monedha që mbajnë emrin e mbretit vërtet duket se paraqesin një figurë femërore mbi kalë. Të tjerat, megjithatë, paraqesin një burrë mbi kalë, ndërsa të tjerat paraqesin një burrë me veshje priftërore. Nuk ka asnjë bazë të fortë metodologjike për të menduar se të parat paraqesin pamjen reale të Verikës, e të fundit jo.

Përballë kësaj duhet vendosur dëshmia aspak e papërfillshme në favor të interpretimit tradicional. Përveç monedhave që sapo u përmendën, kjo përfshin faktin se historiani romak Dio Kasi mendonte se Verika ishte burrë, duke e dhënë emrin e tij si "Beriko" në greqisht. Megjithatë, më e rëndësishmja është dëshmia e mbishkrimeve në vetë monedhat e Verikës. Si sundimtar klient i Perandorisë Romake, Verikës me të drejtë i jepej titulli zyrtar latin rex, që do të thotë mbret. Një numër monedhash që kemi - përfshirë ato që me sa duket paraqesin një figurë femërore - e titullojë Verikën në këtë mënyrë. Kjo është e rëndësishme, sepse ekzistonte një formë krejt e rregullt femërore e rex, përkatësisht regina, domethënë "Mbretëreshë".

Dr. Russell këmbëngul se rex ishte një titull diplomatik i përgjithshëm që u jepej sundimtarëve klientë të Perandorisë Romake në këtë periudhë, pavarësisht gjinisë. Megjithatë, për momentin, ky është një pohim që ende kërkon prova. Sigurisht, ky titull nuk përdoret kurrë në këtë mënyrë në korpusin e gjerë të letërsisë klasike latine.

Për më tepër, Russelli e kundërvë rex-in, që sipas tij ishte neutral ndaj gjinisë, me regis-in qartësisht mashkullor, por ky i fundit është thjesht forma gjinore e të njëjtit emër dhe do të thotë "i mbretit". Kjo është e barasvlershme logjikisht me shpalljen e përemrit modern anglez "he" si neutral ndaj gjinisë, ndërsa njëkohësisht pranohet se "his" është haptazi mashkullor. Disa mund të binden; gjuhëtarët, me gjasë, jo.

Në një kohë kur gratë, me të drejtë, zënë një vend të rëndësishëm në politikë, është joshëse që këtë prani ta projektojmë prapa në burimet tona historike. Megjithatë, kjo do të jetë bindëse vetëm nëse e bëjmë me kujdes dhe me rigorozitet metodologjik. Çdo gjë tjetër është thjesht dëshirë e marrë për realitet.

Mbretërimi i Verikës kishte rëndësi të konsiderueshme. Pas shumë vitesh në fron, ai u rrëzua nga fqinjët e tij lindorë, Katuvellauni, në vitin 42 pas Krishtit. Si përgjigje, iu drejtua aleatëve të tij romakë, dhe rezultati ishte pushtimi romak dhe nënshtrimi i Britanisë jugore që nisi vitin pasues.

Por, a është e mundur që Verika të ketë qenë grua? Ndoshta. A është e mundshme? Fatkeqësisht, jo. /Telegrafi/

SCORSESE, COPPOLA ... DHE MAY? PSE HOLIVUDI U PËRPOQ TA SHTYPTE REGJISOREN E TIJ TË PARË TË MADHE

Nga: Tim ROBEY, kritik filmi / The Telegraph

Teksa të gjithë regjisorët e rinj më premtues në Holivud - si Francis Ford Coppola, Martin Scorsese, William Friedkin dhe Peter Bogdanovich - ishin të zënë duke mbledhur lavdinë e vitit 1973, ishte vetëm një grua së cilës studiot ishin të gatshme t'ia jepnin një mundësi. Besimi i tyre tek Elaine May do të tharbej në mënyrë të pakthyeshme jo shumë kohë më pas, pavarësisht nga talenti - i ndërthurur për të shkruar, për të bërë regji dhe për të interpretuar - për të cilin të gjithë mund ta shihnin se ishte jashtëzakonisht i veçantë.

Woody Alleni e quajti atë "gjeni" dhe frymëzim. Ne do të shkojmë edhe më tej: nuk do të gjeni shumë sinefilë që nuk do të hiqnin dorë nga të paktën një duzinë prej 50 filmave të Allenit, po të nënkuptonte kjo se Elaine May ka mundur të bënte më shumë se vetëm katër.

Filmi i saj i tretë, neonoar [neo-noir] me gangsterë, Miki dhe Niki [Mikey and Nicky, 1976], sapo është riedituar për 50-vjetorin e tij në një version të miratuar nga May (e cila tani është 94 vjeçe). Produksioni ishte aq i trazuar saqë filmi fare lehtë mund të ishte varrosur qysh atëherë, kur u bë i pari nga dy filmat që e çuan Mayn në burgun e regjisorëve. I dyti - fatziu Ishtar i vitit 1987 - bëri që Holivudi, në fakt, ta hidhte tutje çelësin [e burgut].

Miki dhe Niki është historia e një krimineli të vogël nevrik që fshihet (luajtur nga John Cassavetes), i cili nuk e kupton se miku i tij më i mirë (Peter Falk) po ia përcjell fshehurazi vendndodhjen e tyre një vrasësi me pagesë i cili sillet vërdallë me veturë (Ned Beatty). Xhirimet e filmit nisën në Filadelfi në vitin 1973 dhe ai pati një përfundim të hidhur në kinema. Ishte parashikuar të kushtonte 1.8 milionë dollarë dhe të dilte në verën e vitit 1975; në vend të kësaj, buxheti u rrit në 4.3 milionë dollarë (rreth 24 milionë sot), ndërsa May dhe Paramount ngritën padi kundër njëri-tjetrit para se dikush të merrte përsipër ta nxirrte filmin.

May kishte të drejtën e montazhit përfundimtar, por ky privilegj iu hoq pasi ajo i la xhirimet të zgjateshin me muaj, përtej afatit, madje duke i fshehur bobinat në garazhin e një miku për të penguar ndërhyrjen e studios. Kur Paramount-i më në fund e mori materialin filmik, studioja e shkurtoi në mënyrë drastike në një version të çrregullt, plot me gabime, dhe më pas e varrosi në dhjetor të vitit 1976. Kritikët mbetën të hutuar; pothuajse askush nuk arriti ta shihte. Filmit iu deshën dekada për të dalë nga kjo shpërfillje, për t'u restauruar dhe për t'u njohur tani si një vështrim i pamëshirshëm mbi miqësinë mashkullore (dhe mizogjininë).

May kishte qenë në luftë me drejtuesit edhe më parë. Ajo veçse e kishte paditur Paramount-in, pa sukses, për të penguar publikimin e filmit të saj të shkëlqyer debutues, Një gjethe e re [A New Leaf, 1971], pas një montazhi po aq drastik. Kjo komedi e çuditshme romantike, por e errët - në të cilën vetë May luan nusen e turpshme dhe të dashuruar të një vrasësi të mundshëm që thur plane (Walter Matthau) - ia doli mjaft mirë edhe në versionin e Paramount-it: u nominua për dy çmime të Globit të Artë, përfshirë Aktoren më të Mirë për Mayn. Meqë dukej sikur po bënte çmos për të sabotuar një sukses të mundshëm, pikërisht aty duhet të kenë nisur pëshpëritjet për perfeksionizmin e pabindur të skenaristes-regjisores-aktores.

Për lehtësimin e të gjithëve, filmi i saj pasues, Zemërthyesi [The Heartbreak Kid, 1972], kaloi pa probleme, me ndërhyrje minimale nga 20th Century Fox. Në këtë histori dashurie të përmbysur mizorisht, shitësi i pashpirt i luajtur nga Charles Grodin, nis ta braktisë nusen e tij që i rri ngjitur (Jeannie Berlin, vajza e Mayt) gjatë muajit të tyre të mjaltit. Në film luan gjithashtu Cybill Shepherd si studentja e bukur që ai do të donte t'i vardisej në vend të saj, dhe Eddie Albert si babai i Shepherdit i cili e kundërshton fuqishëm këtë lidhje; filmi i Mayit ua siguroi si Albertit, ashtu edhe Berlinit, nominimet për Oskar. Vetëm pas kësaj përvoje pozitive, Paramount-i u bind t'i jepte asaj një shans të dytë.

Si rregull, grave thjesht nuk u lejohej të bënin regji të filmave në Holivud para viteve '80 të shekullit XX - me një numër shumë të vogël përjashtimesh. Para se May t'i merrte këto mundësi, vetëm dy gra ishin lejuar të anëtarësoheshin në Shoqatën e Regjisorëve të Amerikës [Directors Guild of America - DGA] - Dorothy Arzner dhe Ida Lupino. Në vitin 1971, vitin e Një gjetheje të re dhe të padisë së saj të parë kundër Paramount-it, May u bë e treta.

Fakti që dikush e lejoi Mayn të qëndronte pas kamerës i detyrohej punës së saj në komedinë e improvizuar 15 vjet më parë, në partneritet me Mike Nicholsin. Ata ishin të parapëlqyerit e Broduejit me dyshen e tyre, Nikols dhe Mej, para se të ndanin rrugët në vitin 1961 - gjë që Nicholsi, në atë kohë, e përjetoi si katastrofë. Ai u bë një regjisor jashtëzakonisht punëtor, më i vlerësuari në skenën e Nju-Jorkut, dhe më pas



bëri nga kalimet më të bujshme në kinema të regjistruara ndonjëherë, duke fituar Oskarin për Regjinë më të Mirë dy vjet radhazi - më 1967 dhe 1968 (për Who's Afraid of Virginia Woolf? dhe The Graduate).

Rruga e Mayt, si gjithmonë, ishte sfidë. Për të, as edhe një nominim për regji: asnjë grua nuk mori një të tillë deri te pionierja italiane Lina Wertmüller më 1978, dhe vetëm tetë gra të tjera e kanë marrë ndonjëherë këtë nominim (Jane Campion dhe Chloé Zhao nga dy herë, Sofia Coppola, Kathryn Bigelow, Greta Gerwig, Emerald Fennell, Justine Triet dhe Coralie Fargeat), krahasuar me 251 burra.

Ndryshe nga Nicholsi, May do të vazhdonte të aktronte herë pas here në filma dhe të shkruante pjesë teatrale. Prej kohësh është pranuar se ajo ishte forca e vërtetë krijuese e dyshes, ndërsa Nicholsi u jepte formë ideve të saj. Nga katër filmat e saj, vetëm njëri u shkrua nga dikush tjetër (Neil Simon, i cili shkroi Zemërthyesin), dhe fuqia e ndjeshmërisë së saj artistike në atë film ndihet ende. Ajo nuk iu nënshtrua kurrë vizionit të dikujt tjetër dhe as nuk u kënaq duke e bërë atë që i thuhej.

Në një botë tjetër, Ishtari mund ta kishte rehabilituar, në vend që t'ia fundoste përgjithmonë karrierën si regjisore. Kjo komedi aventureske dhe e mundimshme nuk do të ishte realizuar kurrë sikur të dy yjet e filmit, Warren Beatty dhe Dustin Hoffman, të mos mendonin se ia kishin një borxh. May jo vetëm që kishte bashkëshkruar suksesin e madh të Beattyt, Parajsa mund të pret [Heaven Can Wait, 1978] - për të cilin ata u nominuan për Oskar - por, kishte ndihmuar jashtëzakonisht shumë gjatë produksionit problematik të projektit të tij të zemrës, Kuqët [Reds, 1981], duke përpunuar rolet për të cilat Jack Nicholson dhe Diane Keaton do të lavdëroheshin. Më pas, sipas vetë Hoffmanit, rishikimet që May i bëri filmit Tutsi [Tootsie, 1982] bënë që i gjithë filmi të funksionontë, duke pasuruar rolet e grave dhe duke krijuar nga e para personazhin shumë të dashur të Bill Murrayt.

Beatty, në veçanti, mendonte se mund ta mbronte Mayn, duke u përfshirë si producent dhe aktor kryesor dhe duke e mbrojtur nga çfarëdo ndërhyrjeje e rëndë që studioja, Columbia Pictures, mund të imponontë. Koncepti dhe skenari ishin të sajat: filmi do të ishte një variant i një komedie Hope/Crosby, për një dyshe këngëtarësh lokalesh me talent minimal të cilët sigurojnë një angazhim në Marok dhe përfundojnë në mes të zjarrit të një kryengritjeje politike kaotike.

Fakti që filmi do të bëhej sinonim i fryrjes së buxhetit dhe i një dështimi epokal në arkë, kjo duket se prej kohësh i është faturuar Mayt. Disa nga provat e mbështesin këtë; disa jo.

Fiaskoja e Mikit dhe Nikit ia kishte bërë reputacionin jo vetëm si dikush që kundërshtonte kontrollin e studios, por edhe si dikush që xhironte shumë dubla të cilat nuk përdoreshin: mendohet se gjatë 110 netëve të xhirimeve ajo ekspozoi rreth 1.4 milionë këmbë film [426 mijë metra] (tri herë më shumë se sasia e përdorur për Gone with the Wind). Në Ishtar u ekspozua më pak se gjysma e kësaj sasie, por 650 mijë këmbë film [198 mijë metra] janë prapëseprapë shumë.

Sipas raportimeve të shtypit, një pjesë e madhe e tyre u harxhua në dhjetëra dubla me një deve kokëfortë, me të cilën personazhi i Beattyt duhej të përleshet nëpër shkretëtirë. (Edhe kërkimi për ta gjetur devenë e duhur, të cilën May dëshironte që në kamera të dukej e verbër, zgjati gjashtë javë.)

Shtypi sajoi histori të pambështetura për përplasje egosh dhe bëri gjithçka të mundur për ta ekzagjeruar kaosin dhe koston. Krahasoni mënyrën si u trajtua May në krahasim, fjala vjen, me Stanley Kubrickun, dublet po aq të pafundme të të cilit (në The Shining ose Eyes Wide Shut - të dy filmat kaluan një milion këmbë film) bënë që ai të shpallej gjeni i artit të vet, obsesivisht kërkues, dhe jo njeri shpërdorues.

Jo kështu May: thikat ishin nxjerrë kundër saj shumë kohë përpara se Ishtari të mbërrinte me vështirësi në kinema. Dhe, ndonëse pa dyshim është marrëzi, nuk është aspak një nga filmat më të këqij të bërë ndonjëherë (siç deklaruan disa kritikë për ta ushqyer zhurmën). Edhe pse buxheti përfundimtar prej 51 milionë dollarësh ishte i majmë, dy yjet meshkuj morën nga 5.5 milionë dollarë secili, ndërsa pjesa e Mayt ishte vetëm 1.5 milionë dollarë.

Mizogjinia erdhi si sulm nga dy krahë - si nga shtypi, ashtu edhe nga pushtetarët e Holivudit. Pasi David Puttnam u soll për të drejtuar Columbia-n në qershor 1986, Beatty dhe May mendonin se Puttnami po e shfrytëzonte gjithë shtypin toksik për të ndihmuar në sabotimin e daljes së filmit të tyre, për t'ia hedhur fajin regjimit të vjetër dhe për të forcuar pozitën e vet (për më tepër, Chariots of Fire i Puttnamit kishte mundur Reds-in e Beattyt në Oskarët e vitit 1982 dhe që atëherë mes tyre kishte pasur armiqësi). Beatty dhe May filluan të dyshonin për rrjedhje dashakeqe informacioni, si thashethemi se May kishte kërkuar nga ekipi i saj të rrafshonte një dunë të tërë rëre në Sahara, sepse donte një horizont të rrafshët. Nuk ka asnjë provë se kjo ka ndodhur ndonjëherë. Por, kjo ushqeu mitet se May ishte ekscentrike, e vështirë, jashtë realitetit dhe shpërdoruese si e kohës, ashtu edhe e parave.

Sipas këtij leximi të historisë së filmit, Ishtari dhe May ishin thjesht qengja kurbani - të flakur nën autobus gjatë një riorganizimi drejtuesish, në një përplasje egosh që zhvillohej kryesisht mes burrave. Ironikisht, burrat që silleshin në mënyrë toksike dhe gratë që u hidheshin ujqërve ishin pikërisht tema e kalbur që përshkonte të gjithë filmat e Mayt. Ndoshta fakti që ajo i kishte paraqitur këto të vërteta kaq haptazi, nga një këndvështrim femëror që ua ulte djemve përmasat, ishte edhe një arsye tjetër pse donin ta ndalonin.

Nuk kishte asnjë mënyrë që një May t'i mbijetonte një Ishtari - por, një Beatty ia doli, dhe kjo thotë shumë. Ai pati mjaft ndikim saqë brenda pak vitesh të merrte dritën e gjelbër për Dick Tracy dhe Bugsy. Zgjedhja e vetme e Mayt ishte të tërhiqej përsëri në korsinë e saj si skenariste me porosi (bëri një punë të shkëlqyer në The Birdcage dhe në dramën politike të nominuar për Oskar, Primary Colors). Ëndrrat e saj u zvogëluan dhe talenti i saj u vu në zinxhir. Deri tani. Mund të kenë kaluar 50 vjet, por filmografia e vogël dhe e fuqishme e Mayt më në fund po merr vëmendjen që meriton. /Telegrafi/



sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Përfundon Liga e Shkollave

Prishtinë, 11 nëntor - Është përmbyllur edicioni i sivjetmë i Ligës së Shkollave me zhvillimin e tri finaleve të cilat u karakterizuan nga emocione të shumta dhe interesim i madh i tifozëve dhe përkrahësve të sportit shkollor.

Në një atmosferë festive nxënësit patën mundësinë t'i shfaqnin aftësitë e tyre sportive dhe të garonin për trofeun e më të mirit në kategoritë përkatëse. Në kategorinë e vajzave të shkollave fillore triumfoi shkolla "Meto Bajraktari", ndërsa te djemtë e shkollave fillore fituese doli shkolla "Dardania".

Në kategorinë e shkollave të mesme trofeun e kampionit e fitoi shkolla "Xhevdet Doda", duke kompletuar kështu listën e fituesve të këtij edicioni. Në përfundim të garave, fituesit dhe finalistët u shpërblyen me medalje dhe kupa, në një ceremoni që shënoi edhe mbylljen e këtij edicioni të Ligës së Shkollave. Përmes këtyre garave synohet promovimi i sportit në mesin e të rinjve, nxitja e aktivitetit



fizik dhe krijimi i mundësive që nxënësit ta zhvillojnë talentin e tyre sportiv.

UEFA PUBLIKON RENDITJEN E "FAIR PLAY", KOSOVA E 37-ta



Nyon, 11 nëntor - UEFA ka publikuar renditjen përfundimtare të "Fair Play" për sezonin 2025/2026, në të cilën Kosova është pozicionuar në vendin e 37 nga 55 federatat anëtare, me 7.957 pikë. Ndërkaq, në kategorinë që vlerëson sjelljen e shikuesve, pozita e Kosovës është dukshëm më e mirë, pasi renditet e 17-ta. Renditja e publikuar nga UEFA të martën bazohet në vlerësimin e ndeshjeve të të gjitha garave të saj si në nivel klubesh ashtu edhe në atë të përfaqësueseve. Periudha e marrë në shqyrtim përfshin ndeshjet e zhvilluara nga 1 korriku 2025 deri më 30 qershor 2026.

Në klasifikimin e përgjithshëm Kosova ka grumbulluar 7.957 pikë nga 75 ndeshje të vlerësuara. Para saj gjendet, ndër të tjera, Maqedonia e Veriut në vendin e 30, ndërsa pas saj renditen Serbia në vendin e 47 dhe Shqipëria në të 48-tin. Pas Kosovës renditen edhe Kroacia, Qiproja, Gjibraltari dhe Portugalia.

Në krye të renditjes së përgjithshme është Islanda me 8.533 pikë, e ndjekur nga Norvegjia me 8.470 dhe Danimarka me 8.458 pikë. Në pesëshen e parë janë edhe Finlanda dhe Anglia. Për këtë klasifikim janë marrë parasysh vetëm federatat që kanë pasur së paku 50 ndeshje të zhvilluara në garat e UEFA-s gjatë periudhës së caktuar. Një rezultat më pozitiv për Kosovën vërehet në kategorinë e sjelljes së shikuesve, ku renditet në vendin e 17. Ky pozicion tregon se vlerësimi i tifozëve të Kosovës në këtë aspekt është më i mirë sesa pozita e federatës në klasifikimin e përgjithshëm të "Fair Play". Sa i përket përmirësimit të rezultatit të përgjithshëm të "Fair Play" nga një sezon në tjetrin, Kosova ka zënë vendin e gjashtë në Evropë. Progresin më të madh në këtë kategori e ka regjistruar Shqipëria.

"EKZISTON RREZIKU I HUMBJES SË LOJËRAVE MESDHETARE", KOK-U PARALAJMËRON MË TË KEQEN

Prishtinë, 11 nëntor - Bordi ekzekutiv i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), nën udhëheqjen e presidentit Ismet Krasniqi, ka mbajtur mbledhjen e 17, në të cilën janë shqyrtuar pika të ndryshme të rendit të ditës. Ndër pikat kryesore që janë diskutuar kanë qenë edhe Lojërat Mesdhetare "Prishtina 2030", me fokus takimin e fundit të Komitetit Organizativ (OCMG) dhe letrat e ardhura nga Komiteti Ndërkombëtar i Lojërave Mesdhetare (ICMG). "Bordi u njoftua se në javët në vijim pritet të mbahet një takim në Athinë me ICMG, ku OCMG do të përfaqësohet me nga dy përfaqësues nga qeveria, Komuna dhe KOK-u. U konstatua po ashtu se ende ekziston rreziku për humbjen e Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030", ka njoftuar KOK-u.

Gjithashtu, në këtë mbledhje është propozuar krijimi i programit për përgatitjen e federatave për Lojërat Mesdhetare, nismë kjo që buron nga Ligji për LM "Prishtina 2030". Është vendosur që ceremonia e Laureatëve 2026 të mbahet më 21 janar 2027.

Më 30 nëntor do të ftohen federatat për të aplikuar për bursat "Shpresat Olimpike 2026", të cilat mbështeten nga Ministria e Sportit dhe Rinisë. Është diskutuar edhe për Bursat Olimpike LA 28. Pas kërkesës së ardhur nga Federata e Boksit e Kosovës, nga lista është larguar boksieri Donat Syla. Komisioni i Sportit do të mblidhet për ta analizuar performancën e bursistëve të tanishëm si dhe për t'i shqyrtuar kërkesat e reja.



XHUDISTËT E KOSOVËS KËRKOJNË MEDALJE NË ZAGREB



Prishtinë, 11 nëntor - Nga nesër (e premte) deri të dielën në Zagreb të Kroacisë do të mbahet gara Grand Prix e Xhudos, ndërsa Kosova në këtë garë do të paraqitet me gjashtë xhudistë. Te xhudistet garojnë Erza Muminoviq në kategorinë deri në 48 kilogramë, Fatjona Kasapi në kategorinë deri në 52 kilogramë dhe Flaka Loxha në kategorinë deri në 57 kilogramë. Akil Gjakova dhe Dardan Cena garojnë në kategorinë deri në 73 kilogramë, ndërsa në kategorinë deri në 81 kilogramë për Kosovën do të paraqitet Luke Davies. Anglezi Davies, në fakt, debuton për Kosovën. 21-vjeçari deri më tani ka përfaqësuar Britaninë e Madhe dhe ka një karrierë solide. Ai ka shprehur dëshirën për ta zhvilluar më tej karrierën sportive duke iu bashkuar ekipit të Kosovës në xhudo. Gara në Zagreb do të jetë një test i mirë për të. Për xhudistët e Kosovës, në fakt, secila garë tashmë ka rëndësi të madhe. Ka filluar periudha kualifikuese për Lojërat Olimpike "Los Angeles 2028" dhe secila fitore ka peshë sa i përket grumbullimit të pikëve. Akil Gjakova është duke synuar paraqitjen e tretë në Lojërat Olimpike, ndërsa paraqitjen e parë në skenën më të madhe e synojnë Cena, Muminoviq, Kasapi dhe Loxha. Medalja e artë në Grand Prix siguron 700 pikë në ranglistën botërore. Kosova në Zagreb do të jetë pa dy xhudistet më të mira, Distria Krasniqi dhe Laura Fazliu. Krasniqi është duke u rikuperuar nga një lëndim, ndërsa për Fazliun është vendosur të pushojë.

Sunderlandi të paktën një muaj pa Xhakën

Sunderland, 11 nëntor - Lëndimi i kapitenit Granit Xhaka ka shqetësuar drejtuesit e Sunderlandit, pasi mesfushori mund të qëndrojë jashtë fushës për më shumë se një muaj. Xhaka ishte lënduar në minutën e katërt të ndeshjes me Chelsean, ndërsa për shkak të këtij lëndimi nuk ka mundur të grumbullohet me Zvicrën për ndeshjet e Ligës së Kombeve. Te skuadra angleze janë duke shpresuar që Xhaka të jetë i gatshëm për lojë pas pushimit ndërkombëtar, por thuhet se gjasat janë shumë të vogla. Madje është raportuar se Xhaka pritet t'i mungojë Sunderlandit në katër ndeshje kampionale, ndaj Aston Villas, Tottenhamit, Liverpoolit dhe Newcastle Unitedit. 34-vjeçari pritet të rikthehet në fushë dhe të jetë gati për lojë në mesin e muajit dhjetor. Mungesa e tij gjatë kësaj periudhe do të ndihet shumë te Sunderlandi, ekip që po lufton për mbijetesë.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "MAKE BZ " SH.P.K. me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812342012 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "MAKE BZ " D.O.O. sa sjedištem u Vuqiterrn, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812342012 ujedno imenovao Likvidatora o spovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "MAKE BZ " L.L.C. with headquarters Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 812342012 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me operatorin "MINERAL" L.L.C. Çiktovë e Vjeter- Gllogoc, kërkesa për Leje Mjedisore, me nr. prot. 26/736/MMPH, për bazë e betonit në Çiktovë e Vjeter- Gllogoc, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 04.12.2026, në ora: 10:00, në hapësirat e Objektit të Administratës të kompanisë "MINERAL" L.L.C. Çiktovë e Vjeter- Gllogoc, do të organizohet debat publik nga operatori "MINERAL" L.L.C. Çiktovë e Vjeter- Gllogoc, kërkesa për Leje Mjedisore, me nr. prot. 26/736/MMPH, për bazë e betonit në Çiktovë e Vjeter- Gllogoc, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

Meeting ID: 978 061 9194
Passcode: LsKi3H

https://us05web.zoom.us/j/9780619194?pwd=utLa9j36e3WHTyhKaJw72N2IbG2oQ9.1

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPH-së, për komente të publikut:

https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=MATR

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,

_____

"MINERAL" L.L.C. Çiktovë e Vjeter- Gllogoc



Zvogëlim i kapitalit nga firma EUROFAMIS Sh.A

Firma "EUROFAMIS" Sh.A, me numër UNIK IDENTIFIKUES, NUI: 811306431, me seli në Shirokë, Suharekë, bën zvogëlimin e kapitalit nga vlera 910.000,00 euro në vlerën 10.000,00 euro.



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- DENIS JUSUFI shpalle te pavleshme diplomen dhe deftesat e vitit I ,II,III te SHMLT ARKITEKT SINANI

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - Vlll shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K "11 Marsi " Prizren.

- Trim Rezniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p "Gjon N. Kazazi" Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE

Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Në bazë të Nenit 21, paragraf;t 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 03/L-087, datë 13 Qershor 2008, Për Ndërmarrjet Publike [1], i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, datë 20 Prill 2012[2] dhe Ligjin Nr. 05/L-009, datë 07 Prill 2015[3], lidhur me dispozitat tjera në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e punës, Nenit 23, Paragrafi 3, nënparagrafi 6 i Statutit Nr. 01-592/1, datë 29 Mars 2023, të Ndërmarrjes Publike Banesore SHA Prishtinë – NPB SHA Prishtinë dhe Rregullores Nr. i Protokollit: 01-336/2, datë 11 Mars 2025, Për Sistematizimin e Vendeve të Punës, Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të NPB SHA Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur më datë 31 Tetor 2026, mori Vendim[4], për të shpallur:

KONKURS

Titulli i Kokursit: Këshilltar/e i/e Përgjithshëm – Sekretar/e Koorporativ/e në NPB SHA Prishtinë.

Nr. Referencës: 01-872/1, datë 02.11.2026
Mbikëqyrësi: Bordit të Drejtorëve NPB-së, Sh.A. Prishtinë
Niveli i Pagës: Niveli 2.1
Orari i punës: I plotë – 40 orë në javë.
Kohëzgjatja e mandatit: Me kohë të caktuar 3 (tre) vite
Vendi i punës: Ndërmarrja Publike Banesore SHA Prishtinë – NPB SHA Prisahtinë.

II. Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:
Sekretari Koorporativ i Ndërmarrjes Publike Banesore SHA Prishtinë, në përputhje me dispozitat e parapara të Ligjit Nr. 06/L-016, datë 15 Mars 2018, Për Shoqëritë Tregtare[5] dhe Ligjit për Ndërmarrjet Publike, ka këto detyra dhe përgjegjësi:

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sigurohet që të përcillen procedurat e Bordit, ku bëjnë pjesë organizimi i takimeve të Bordit, Komiteteve të Bordit dhe Aksionarëve duke përfshirë (në bashkëpunim me Kryesuesin) përgatitjen dhe shpërndarjen e agjendave;
- Mban regjistrin e aksionarëve;
- Koordinon me KE përgatitjen e materialit për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
- Mban procesverbalin e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesit e tyre) dhe i regjistron në librat e protokolleve;
- Shpërndan procesverbalet tek drejtorët dhe aksionarët;
- Merret me regjistrimin zyrtar të ndryshimeve të cilat kërkohen sipas ligjit, i regjistron në regjistrin e Kosovës për shoqëritë tregtare dhe emrat tregtarë;
- Sipas udhëzimeve nga Kryesuesi, përgjegjësitë e Sekretarit përfshijnë sigurimin e rrjedhjes së mirë të informatave brenda Bordit dhe komiteteve të tij dhe në mes të Bordit dhe menaxherëve të lartë të Ndërmarrjes;
- Këshillat dhe shërbimet e Sekretarit duhet të jenë në dispozicion të të gjithë drejtorëve i cili njëheri është përgjegjës tek Bordi për të siguruar që përputhen procedurat e Bordit;
- Sekretari/ja i/e Ndërmarrjes i raporton Bordit dhe Kryeshefit/es Ekzekutiv/e si dhe është përgjegjës për komunikimet e informatave, raporteve dhe vendimeve të mbledhjeve të Bordit për t'i përcjellë te Aksionari;
- Jep opinione, harton dokumente të ndryshme ligjore, këshillon, përfaqëson, koordinon përfaqësimin e Ndërmarrjes para organeve administrative;
- Merret edhe me çështjet tjera të qeverisjes korporative sipas nevojës.

Kualifikimi i Kërkuar:

- Diplomë universitare drejtimi Juridik;
- Përvojë pune 5 vjeçare;
- Përvojë të konsiderueshme profesionale së paku 3 vite nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtës së shoqërive tregtare.

Aftësitë e Kandidatit:

- Njohje e sektorit publik/lokal;
- Aftësi për punë ekipore;
- Aftësi të shprehura komunikimi;
- Preferohet njohja e gjuhëve të huaja;
- Të ketë etikë në punë dhe integritet të lartë.

IV. Informatë për procedurën e konkurrimit
Kandidatët për Sekretar Koorporativ, duhet t'i dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- Aplikacionin;
- CV-në;
- Dëshminë mbi kualifikimin profesional;
- Dëshminë mbi përvojën e punës si dhe referencat e punës;
- Deklaratën nën Betim (gjendet në aplikacion në web faqe të NPB SHA Prishtinë);
- Autorizimin që lejon NPB SHA Prishtinë të grumbullojë dhe administrojë të dhënat personale të saj/tij.
- Certifikatën që nuk është nën hetime nga Gjykata (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Certifikatën e shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Kopjen e letërnjoftimit;

Aplikimi:

- Formulari i Aplikimit shkarkohet në web: Formular-i-aplikimit-per-punesim.doc.
- Të gjitha dokumentet e kërkuara për aplikim duhet të dërgohen në mënyrë elektronike në adresë zyrtare: **info@npbanesore.com.**
- Të gjitha dokumentet duhet të jenë të bashkëngjitura në formatin PDF.
- Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe email adresën.
- Vetëm kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e parapara me konkurs, do të përzgjedhjen për procedurat e konkursit.

Njoftim PËR PRIVATËSINË DHE PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE
Ndërmarrja Publike Banesore SHA Prishtinë – NPB SHA Prishtinë, me seli në Prishtinë, në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave personale, informon kandidatët për punën lidhur me përpunimin e të dhënave personale gjatë procesit të rekrutimit.

1. **Qëllimi i përpunimit:**

Të dhënat personale përpunohen me qëllim të:

- Zhvillimit të procedurës së rekrutimit dhe përzgjedhjes;
- Verifikimit të kualifikimeve profesionale;
- Ushtrimit të së drejtës së ankesës;
- Themelimit të marrëdhënies së punës për kandidatët e përzgjedhur.

2. **Llojet e të dhënave që përpunohen:**

- Të dhënat identifikuese (emër, mbiemër, datëlindje, numri personal);
- Të dhënat e kontaktit;
- Të dhënat mbi arsimin dhe përvojën profesionale;
- Dokumentet mbështetëse të aplikimit;
- Të dhëna të tjera të kërkuara sipas konkursit.

3. **Baza ligjore:**

Përpunimi i të dhënave personale bëhet në përputhje të plotë me:

- Ligjin Nr. 06-L/062, datë 30 Janar 2019, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale[6];
- Ligjin Nr. 03/L-212, datë 01 Nëntor 2010, I Punës[7].
- Ligjin Nr. 03/L-087, datë 13 Qershor 2008, Për Ndërmarrjet Publike[8], i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, datë 20 Prill 2012[9] dhe Ligjin Nr. 05/L-009, datë 07 Prill 2015[10];
- Rregulloren Për Mbrojtjen e të Dhënave[11] në NPB SHA Prishtinë, si dhe aktet nënligjore të brendshme.

4. **Afati i ruajtjes:**

- Të dhënat personale të kandidatëve që me vullnetin e tyre nuk i nënshtrohen procedurës së rekrutimit pjesërisht apo në tërësi, ruhen deri në tridhjetë (30) ditë, nga përfundimi i procedurës së rekrutimit.
- Të dhënat personale të kandidatëve të papërzgjedhur ruhen deri në një (1) vit nga përfundimi i procedurës së rekrutimit.
- Të dhënat e kandidatëve të përzgjedhur ruhen në dosjen personale gjatë marrëdhënies së punës dhe më pas sipas legjislacionit arkivor.

5. **Qasja dhe siguria.**Të dhënat personale përpunohen vetëm nga persona të autorizuar dhe m brohen me masa teknike e organizative të përshtatshme.
6. **Të drejtat e kandidatëve:** Kandidatët kanë të drejtë: Të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre; Të kërkojnë qasje në të dhënat e tyre, korrigjim ose fshirje të tyre sipas ligjit; Të paraqesin ankesë pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi.
7. **Kontakti:**

Për pyetje lidhur me përpunimin e të dhënave personale, kandidatët mund të kontaktojnë: NPB SHA Prishtinë – Divizioni i Burimeve Njerëzore.

Lagje "ULPIANA", **Rr.** "Zija SHEMSIU", **Nr.** 22, 10000, Prishtinë.
burimet.njerezore@npbanesore.com

Afati për aplikim është nga data 12 Nëntor deri më 11 Dhjetor 2026, në orën 16:00.

NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE
Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Na osnovu člana 21. stavova 3. i 4. Zakona br. 03/L-087, od 13. juna 2008. godine, o javnim preduzećima, izmenjenog i dopunjenog Zakonom br. 04/L-111, od 20. aprila 2012. godine, i Zakonom br. 05/L-009, od 7. aprila 2015. godine, u vezi sa ostalim važećim odredbama kojima se uređuju radni odnosi, člana 23. stav 3. podstav 6. Statuta br. 01-592/1, od 29. marta 2023. godine, Javnog stambenog preduzeća A.D. Priština – NPB A.D. Priština, kao i Pravilnika br. protokola: 01-336/2, od 11. marta 2025. godine, o sistematizaciji radnih mesta, Privremeni odbor direktora NPB A.D. Priština, na sednici održanoj dana 31. oktobra 2026. godine, doneo je Odluku o raspisivanju:

KONKURSA

Naziv konkursa: Generalni savetnik/ca – Korporativni sekretar/ka u NPB A.D. Priština.

Referentni broj: 01-872/1, od 02.11.2026. godine

Neposredni rukovodilac: Odbor direktora NPB A.D. Priština

Nivo plate: Nivo 2.1

Radno vreme: Puno radno vreme – 40 sati nedeljno.

Trajanje mandata: Na određeno vreme, u trajanju od 3 (tri) godine.

Mesto rada: Javno stambeno preduzeće A.D. Priština – NPB A.D. Priština.

II. Uslovi i tražene kvalifikacije

Korporativni sekretar Javnog stambenog preduzeća A.D. Priština, u skladu sa odredbama predviđenim Zakonom br. 06/L-016, od 15. marta 2018. godine, o privrednim društvima, i Zakonom o javnim preduzećima, obavlja sledeće dužnosti i odgovornosti:

Dužnosti i odgovornosti:
Stara se o poštovanju procedura Odbora, što obuhvata organizovanje sednica Odbora, odbora Odbora i akcionara, uključujući (u saradnji sa predsedavajućim) pripremu i distribuciju dnevnih redova;
Vodi registar akcionara;
Koordinira sa izvršnim direktorom (KE) pripremu materijala za sednice Odbora direktora;
Vodi zapisnike sa sednica Odbora direktora i Komisije za reviziju (osim ako njihovi predsedavajući ne zahtevaju drugačije) i evidentira ih u protokolarnim knjigama;
Dostavlja zapisnike direktorima i akcionarima;
Bavi se zvaničnom registracijom promena koje su zakonom propisane i registruje ih u Kosovskom registru privrednih društava i trgovačkih naziva;

Prema uputstvima predsedavajućeg, odgovornosti sekretara obuhvataju obezbeđivanje nesmetanog protoka informacija unutar Odbora i njegovih odbora, kao i između Odbora i višeg rukovodstva Preduzeća;
Saveti i usluge sekretara moraju biti dostupni svim direktorima, pri čemu je sekretar istovremeno odgovoran Odboru za obezbeđivanje usklađenosti sa procedurama Odbora;
Sekretar/ka Preduzeća odgovara Odboru i glavnom izvršnom direktoru/ki, kao i za komunikaciju i prosleđivanje informacija, izveštaja i odluka sa sednica Odbora akcionaru;
Daje pravna mišljenja, izrađuje različita pravna dokumenta, pruža pravne savete, zastupa i koordinira zastupanje Preduzeća pred administrativnim organima;
Obavlja i druge poslove iz oblasti korporativnog upravljanja, prema potrebi.

Potrebne kvalifikacije:
Univerzitetska diploma pravnog smera;
Pet (5) godina radnog iskustva;
Značajno profesionalno iskustvo od najmanje tri (3) godine u oblasti korporativnog upravljanja ili prava privrednih društava.
Sposobnosti kandidata:
Poznavanje javnog/lokalnog sektora;
Sposobnost timskog rada;
Izražene komunikacione veštine;
Poznavanje stranih jezika smatra se prednošću;
Izražena poslovna etika i visok nivo integriteta.
IV. Informacije o postupku konkurisanja
Kandidati za poziciju Korporativnog sekretara dužni su da dostave sledeću dokumentaciju:

Prijavni obrazac;
Biografiju (CV);
Dokaz o stručnoj kvalifikaciji;
Dokaz o radnom iskustvu, kao i preporuke sa prethodnih radnih mesta;
Izjavu pod zakletvom (dostupna u prijavnom obrascu na veb-stranici NPB A.D. Priština);
Ovlašćenje kojim se dozvoljava NPB A.D. Priština da prikuplja i obrađuje njegove/njene lične podatke;
Uverenje nadležnog suda da se protiv kandidata ne vodi krivični postupak (ne starije od šest meseci);
Uverenje o državljanstvu Republike Kosovo;
Kopiju lične karte.
Prijave, zajedno sa izjavom pod zakletvom, mogu se dostaviti elektronskim putem, slanjem tražene dokumentacije na zvaničnu adresu: **info@npbanesore.com**.
Sva dokumentacija mora biti priložena u PDF formatu.
Kandidati koji se prijavljuju dužni su da tačno navedu svoju adresu, kontakt telefon i imejl adresu.
Samo kandidati koji ispunjavaju uslove predviđene konkursom biće uzeti u obzir u daljem postupku selekcije.

OBAVEŠTENJE O PRIVATNOSTI I OBRADI LIČNIH PODATAKA

Javno stambeno preduzeće A.D. Priština – NPB A.D. Priština, sa sedištem u Prištini, u svojstvu rukovaoca ličnim podacima, obaveštava kandidate za posao o obradi njihovih ličnih podataka tokom postupka zapošljavanja.

1. Svrha obrade
Lični podaci se obrađuju u sledeće svrhe:

Sprovođenje postupka zapošljavanja i izbora kandidata;
Provera stručnih kvalifikacija;
Ostvarivanje prava na žalbu;
Zasnivanje radnog odnosa sa izabranim kandidatima.
2. Vrste podataka koji se obrađuju
Identifikacioni podaci (ime, prezime, datum rođenja, lični broj);
Kontakt podaci;
Podaci o obrazovanju i profesionalnom iskustvu;
Prateća dokumentacija uz prijavu;
Drugi podaci zahtevani konkursom.
3. Pravni osnov
Obrada ličnih podataka vrši se u potpunosti u skladu sa:

Zakonom br. 06/L-062, od 30. januara 2019. godine, o zaštiti ličnih podataka;
Zakonom br. 03/L-212, od 1. novembra 2010. godine, o radu;
Zakonom br. 03/L-087, od 13. juna 2008. godine, o javnim preduzećima, izmenjenim i dopunjenim Zakonom br. 04/L-111, od 20. aprila 2012. godine, i Zakonom br. 05/L-009, od 7. aprila 2015. godine;
Pravilnikom o zaštiti podataka u NPB A.D. Priština, kao i internim podzakonskim aktima.
4. Rok čuvanja podataka
Lični podaci kandidata koji svojom voljom ne učestvuju u postupku zapošljavanja, delimično ili u celini, čuvaju se do trideset (30) dana od dana završetka postupka zapošljavanja.
Lični podaci kandidata koji nisu izabrani čuvaju se do jedne (1) godine od dana završetka postupka zapošljavanja.
Podaci izabranih kandidata čuvaju se u personalnom dosijeu tokom trajanja radnog odnosa, a nakon toga u skladu sa arhivskim zakonodavstvom.
5. Pristup i bezbednost
Lični podaci se obrađuju isključivo od strane ovlašćenih lica i štite se odgovarajućim tehničkim i organizacionim merama.

6. Prava kandidata
Kandidati imaju pravo:

Da budu informisani o obradi svojih ličnih podataka;
Da zahtevaju pristup svojim podacima, njihovu ispravku ili brisanje, u skladu sa zakonom;
Da podnesu žalbu Agenciji za informacije i privatnost.

7. Kontakt
Za pitanja u vezi sa obradom ličnih podataka, kandidati se mogu obratiti:

NPB A.D. Priština – Odeljenje za ljudske resurse

Naselje „ULPIANA", Ulica „Zija Šemsiju", br. 22, 10000 Priština.

burimet.njerezore@npbanesore.com

Rok za podnošenje prijava je od 12.11.2026–11.12.2026, do 16:00 časova.

NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SHA PRISHTINË
NUI: 810500604; **Nr. i Biznesit:** 70170765; **Nr. Fiskal:** 600390033; **Nr. i TVSH:** 330031063.

Prishtinë, ___/___/_____.
Ekzemplar: I vetëm.

Unë _____ _____ _____,
(Emri) (Emri i Prindit) (Mbiemri)

i/e lindur më __/__/_____, i/e lindur në _____, banues në _____, me Nr. Personal: __/__/__/__/__/__/__/__/__/__/__, me nënshkrimin e këtij dokumenti,

D E K L A R O J

Se të dhënat e mia të shënuara më lartë janë të sakta dhe do të ofroj çdo dokument apo të dhënë që mund të më kërkohet nga zyrtarët e Ndërmarrjes Publike Banesore SHA Prishtinë dhe njëkohësisht në bazë dhe zbatim të Ligjit Nr. 06/L–082, datë 30 Janar 2019, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale[1], Kreut II, Nenit 5,

A U T O R I Z O J

Ndërmarrjen Publike Banesore SHA Prishtinë, që të grumbullojë, administrojë, ruajë, përdorë, sipas nevojës në bazë të normimit pozitiv edhe të publikojë, si dhe të bëjë verifikimet e duhura për mua apo të dhënat që lidhen me mua, për shkak të _____.

Në çdo kohë që vërtetohet që të dhënat që kam dhënë nuk janë të sakta, pranoj të më shkëputet menjëherë marrëdhënia e punës, si dhe të ndëshkohem me norma të përshkallëzuara sipas ligjeve në fuqi.

N Ë N S H K R I M I

_____
Emri, Mbiemri dhe Firma

[1] Dekreti Nr. DL–059–2019, datë 14 Shkurt 2019. Gazeta Zyrtare Nr. 6, datë 25 Shkurt 2019, Prishtinë.

NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SHA PRISHTINË
NUI: 810500604; **Nr. i Biznesit:** 70170765; **Nr. Fiskal:** 600390033; **Nr. i TVSH:** 330031063.

Ekzemplar: I vetëm.

Në bazë dhe zbatim të Ligjit Nr. 03/L–087, datë 13 Qershor 2008, Për Ndërmarrjet Publike[1], i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L–111, datë 20 Prill 2012[2] dhe Ligjin Nr. 05/L–009, datë 07 Prill 2015[3],

Unë i nënshkruari: _____, i/e lindur më: ___/___/_____, në _____, aplikues për pozitën Sekretar në Ndërmarrjen Publike Banesore SHA Prishtinë,jap këtë

DEKLARATA NËN BETIM

I përmbushi të gjitha kushtet e kualifikimit dhe përshtatjes profesionale sipas Nenit 17 të Ligjit Për Ndërmarrjet Publike, lidhur me dispozitat e tjera në fuqi që rregullojnë këtë çështje.

Po ashtu, deklaroj se nuk jam në konflikt të interesit dhe se në çdo kohë që mësoj se gjatë kësaj procedure të aplikimit, konkurimit dhe përzgjedhjes mund të lind rrethanë e konfliktit të interesit në lidhje me mua, do e deklaroj menjëherë.

Ekzistimi i çfarëdo pasaktësie apo kundërthënie me të dhënat e kësaj deklarate nënkupton skualifikimin tim të menjëhershëm.

Emri dhe Mbiemri:	Nënshkrimi:

Data: __/Nëntor 2026.

[1] Gazeta Zyrtare Prishtinë, Viti III, Nr. 31, datë 15 Qershor 2008.
[2] Dekreti Nr. DL–017–2012, datë 17 Maj 2012. Gazeta Zyrtare Nr. 13, datë 30 Maj 2012, Prishtinë.
[3] Dekreti Nr. DL–006–2015, datë 24 prill 2015. Gazeta Zyrtare Nr. 10, datë 07 Maj 2015, Prishtinë.

Adresa: Rr. "Zija SHEMSIU", **Nr.** 22, Prishtinë, 10000. **Nr. Tel.** +383 (0) 38/606–672; 0800/11–672; **E–mail:** info@npbanesore.com; **WEB:** https://npbanesore.com
Faqe 1 nga 1




MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES